



2021

RAPORTI VJETOR



©Të drejtat e autorit të Inspektoratit Policor të Kosovës

Teksti i këtij dokumenti mund të riprodhohet falas në çdo format ose medium, me kusht që të riprodhohet me saktësi dhe jo në një kontekst ndryshe nga se raportohet këtu.

Ky material duhet të njihet si e drejtë e autorit (Inspektoratit Policor të Kosovës) dhe dokumenti si titulli i specifikuar.

Kur është identifikuar materiali nga pala e tretë, leja nga mbajtësi i të drejtës së autorit duhet të kërkohet.

Çdo pyetje në lidhje me këtë publikim duhet të na dërgohet në:

Inspektorati Policor i Kosovës,

Rruga “Dëshmorët e Gollakut”,p.n, Hajvali, Prishtinë,

Tel: 038 200 19 691,+383 (0)38 521 201

E-mail: zimp.ipk@rks-gov.net

inspektoratipolicor@gmail.com

SHKURTESAT

AKSP	Akademia e Kosovës për Siguri Publike
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
DBI	Divizioni për bashkëpunim dhe informim
DFSHP	Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme
DH	Departamenti i Hetimeve (IPK)
DI	Departamenti i Inspektimeve
DIA	Drejtoria për Inteligjencë dhe Analizë
DMA	Departamenti për Menaxhimin e Ankesave
DMH	Drejtoria për Migrim dhe të Huaj
DMO	Drejtoria për Menaxhimin e Objekteve
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
DRP	Drejtoria Rajonale e Policisë
DRK	Drejtoria Rajonale Kufitare
DKRR	Divizioni i Komunikacionit Rrugor
DHBVK	Drejtoria për Hetime të Brendshme dhe Verifikim të Kaluarës
DSHAM	Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim
EVS	Ekipi Veprues për Siguri në Bashkësi
FRONTEX	The European Border and Coast Guard Agency
ICITAP	Internacional Criminal Investigative Training Assistance Program
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
KKSB	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
NJKA	Njësia e Kontrollit të Autostradës
NJRKR	Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PK	Policia e Kosovës
PSO	Procedura Standarde e Operimit
SIPK	Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës
SPK	Stacioni Policor Kufitar
SPMK	Stacioni Policor për Mbikëqyrje të Kufirit
TI	Teknologjia Informative
UNMIK	United Nations Interim Administration Mission in Kosovo

PËRMBAJTJA

1.	RRETH NESH	6-6
2.	FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV	7-7
3.	HYRJE.....	8-8
4.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	9-9
5.	MENAXHIMI I ANKESAVE	11-15
6.	HETIMET PENALE	17-25
7.	INSPEKTIMET E STRUKTURAVE DHE FUNKSIONEVE POLICORE	27-40
8.	MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN, PROMOVIMI DHE BASHKËPUNIMI	41-46
9.	SHËRBIMET FINANCIARE, ADMINISTRATIVE DHE MBËSHTETËSE.....	47-50

1. RRETH NESH

Historik i shkurtër

IPK është mekanizëm i pavarur mbikëqyrës, i pavarur nga Policia e Kosovës dhe funksionon sipas modelit të vendeve perëndimore që aplikojnë standarde të larta ndërkombëtare të kontrollit policor dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Është themeluar në korrik të vitit 2006 në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr.2005/54 dhe Urdhëresës Administrative nr.2006/9, si Agjenci Ekzekutive në kuadër të MPB-së. Bazuar në këto akte, ka funksionuar deri me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 03/L-136 për IPK-në, të miratuar në vitin 2008. Më pas, për shkak të ndryshimit të mandatit ligjor në fushën e hetimeve, nga viti 2010, IPK-ja funksionon bazuar në Ligjin nr. 03/L-231, i cili ka hyrë në fuqi më 1 Dhjetor 2010.

Fushëveprimi

Objekt i veprimtarisë së IPK-së është:

1. Parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj;
2. Inspektimi i strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës, për të siguruar llogaridhënie, efektivitet dhe efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore dhe procedurave standarde të operimit në fuqi;
3. Hetimi dhe/ose inspektimi i incidenteve disiplinore të profilit të lartë, ku përfshihen të gjithë punonjësit policor me gradën më të lartë të nivelit

të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve policor të nivelit të lartë ekzekutiv;

4. Kur ekziston dyshimi i bazuar se Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ka kryer shkelje disiplinore, Kryeministri mund të autorizon Inspektoratin Policor të Kosovës për zhvillim të hetimeve disiplinore. Inspektorati Policor i Kosovës pas përfundimit të hetimeve disiplinore i raporton Kryeministrit për të gjeturat;

5. Pranimi i të gjitha ankesave të qytetarëve, si dhe shqyrtimi dhe përcaktimi se cilat nga ankesat hetohen nga Inspektorati Policor i Kosovës dhe cilat do t'i referohen Policisë së Kosovës apo institucioneve përgjegjëse.

Misioni

Misioni i IPK-së është që përmes ushtrimit të veprimtarisë së tij, të sigurojë një shërbim policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara.

Vizioni

IPK synon fuqizimin e rolit të tij në funksion të rritjes së integritetit, profesionalizmit dhe ofrimit të shërbimeve profesionale dhe etike për qytetarët.

Parimet tona

Si një agjenci e përkushtuar për t'iu shërbyer interesave të të gjithë qytetarëve, IPK-ja udhëhiqet nga vlerat, si: përgjegjshmëria, profesionalizmi, objektiviteti, paanshmëria, mosdiskriminimi, transparenca, efikasiteti dhe efektiviteti.

2. FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Inspektorati Policor i Kosovës bazuar në misionin e vet ligjor, gjatë vitit 2021 ka arritur të evidentoj rezultate që kanë ndikim pozitiv për rendin dhe sigurinë e Republikës së Kosovës. Këto rezultate pozitive tregojnë për dedikimin e secilit punonjës të IPK-së, prandaj në fillim duhet të falënderoj secilin punonjës në IPK. Falë punës dhe angazhimit të tyre të pakursyer, Inspektorati Policor i Kosovës edhe në vitin 2021 ka



evidentuar suksese në përmbushjen e misionit të IPK duke fuqizuar besimin e qytetarëve në këtë agjenci të zbatimit të ligjit. Ky fuqizim i besimit të qytetarëve është shprehur në rritjen e trendit të numrit të ankuesve.

Gjatë vitit 2021 në IPK janë pranuar rreth 22% për më shumë ankesa se në vitin 2020 nga qytetarët e Republikës së Kosovës. Sipas analizave të Inspektoratit Policor të Kosovës, rritja e numrit të ankesave në 2020 kundër punonjësve të Policisë së Kosovës është manifestim i së paku dy (2) faktorëve kryesor.

Në njërën anë rritja e numrit të ankesave kundër punonjësve policor mund të shpjegohet si rritje paralele me rritjen e punës së Policisë e Kosovës gjatë pandemisë Covid-19. Në anën tjetër nuk ka asnjë dyshim se rritja e numrit të ankesave në IPK ka të bëjë edhe me rritjen e besimit të qytetarëve në punën, profesionalizmin dhe transparencën e Inspektoratit Policor të Kosovës. Prandaj Inspektorati Policor i Kosovës është shumë mirënjohës ndaj të gjithë qytetarëve të Kosovës pa dallim, të cilët kanë bashkëpunuar ngushtë me Inspektoratin Policor të Kosovës dhe kanë dhënë kontributin kryesor për të garantuar një shërbim profesional, demokratik dhe transparent të Policisë së Kosovës.

Sa i përket ankesave kundër punonjësve policor, duhet shtuar se Inspektorati Policor i Kosovës në vazhdimësi ka promovuar mundësinë e paraqitjes së ankesave në mënyrë elektronike për të zvogëluar në maksimum mundësitë për infektim me Covid-19.

Rrjedhimisht gjatë vitit 2021 është evidentuar një rritje e konsiderueshme e numrit të ankesave elektronike duke pranuar rreth 35% të tyre në këtë mënyrë.

Hetuesit dhe inspektorët në IPK kanë dëshmuar nivelin më të lartë të profesionalizmit në punë edhe gjatë vitit 2021. Në njërën anë falë punës së hetuesve në IPK në vitin 2020 është evidentuar një rritje e numrit të kallëzimeve penale kundër punonjësve policor për vepra të ndryshme penale. Në anën tjetër inspektorët kanë përfunduar me sukses të lartë gjithsej nëntë (9) inspektime në fusha të ndryshme policore nga të cilat kanë derivuar 80 rekomandime për Policinë e Kosovës.

Duhet theksuar se krahas përmbushjes me sukses të detyrave dhe përgjegjësi të zakonshme ligjore, Inspektorati Policor i Kosovës që nga fillimi i pandemisë ka implementuar plan operativ për monitorimin e masave për luftimin e Covid-19 nga Policia e Kosovës.

Inspektorati Policor i Kosovës mbetet i përkushtuar për të përmbushur në mënyrë profesionale dhe transparente të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e veta ligjore, në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë qytetarët e vendit dhe institucionet tjera kompetente.

IPK falënderon partnerët ndërkombëtarë duke përfshirë këtu ICITAP-in, OSBE-në të cilët ndihmuan IPK-në edhe këtë vit në zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale dhe teknike. Falë përkrahjes nga ICITAP-i, IPK këtë vit pranoi konfirmimin zyrtar për anëtarësimin e plotë në Shoqatën Kombëtare të Hetuesve të Punëve të Brendshme (NIAIA – National Internal Affairs Investigators Association) të SHBA-së duke qenë shteti i parë nga Evropa që u anëtarësua në këtë organizatë.

3. HYRJE

Ky është Raport përmbledhës i punës së IPK-së për periudhën janar - dhjetor 2021, i cili përmban aktivitete dhe të arritura të dokumentuara. Raporti i këtij viti pasqyron sfidat dhe aktivitetet e ndërmarra bazuar në kompetencat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe të arriturat kryesore gjatë kësaj periudhe.

Në drejtim të ngritjes së transparencës dhe ofrimit të informacionit për qytetarëve mbi punën që bëjmë, IPK-ja praktikon që të publikojë një dokument përmbledhës në standardin e një Raporti të rregullt vjetor, ku pasqyrohen sfidat dhe angazhimet tona në përmbushje të përgjegjësive dhe misionit ligjor.

IPK vlerëson se nga viti në vit puna jonë vazhdon të jetë më cilësore dhe këtë e dëshmojnë rezultatet tejet mbresëlënëse. Rezultatet konsiderohen se janë të përbashkëta, ngase pjesë të suksesit tonë bartin dhe qytetarët që ofruan një bashkëpunim në denoncimin e shkeljeve nga radhët policore, por edhe partnerët tanë që na mbështetën në këtë rrugëtim.

Përgjegjësitë dhe detyrat që lidhen me funksionet e saj, IPK i ka të ndara në departamente. Bazuar në Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës për punonjësit e IPK-së, agjencia jonë është e strukturuar në pesë (5) departamente, prej të cilave, katër (4) janë operative dhe një (1) mbështetës. Roli i secilit departament është i shtjelluar në brendësi të këtij Raporti.

Raporti i këtij viti është i ndarë në disa kapituj, ku pasqyrohen aktivitetet e departamenteve, rezultatet e punës dhe sfidat në arritjen e rezultateve.

IPK-ja do të vazhdojë të jetë e përkushtuar në ngritjen e cilësisë së shërbimit, në përmbushje të mandateve që dalin nga Ligji për IPK-në, në drejtim të sigurimit që Policia e vendit tonë të zhvillohet si forcë e përgjegjshme, profesionale dhe demokratike. Ky mision konsiderohet i rëndësishëm për ne, andaj dhe interesi ynë është që Policia të zhvillohet krahas standardeve ndërkombëtare.

Në përfundim të kësaj hyrjeje, vlerësojmë se edhe pse kemi ofruar disa dritare të informimit të qytetarëve mbi angazhimet tona, ne zotohemi se edhe në të ardhmen do të vazhdojmë t'iu ofrojmë informacionin me kohë dhe për kureshtjen tuaj, siç vazhdon të jetë edhe kjo praktikë e raportimit e shprehur përmes këtij Raporti.

4. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në këtë përmbledhje janë pasqyruar informata të dala nga analizat e kryera mbi performancën e organizatës në të gjitha drejtimet, bazuar në mandatet e përcaktuara me Ligjin për IPK-në.

Jemi angazhuar që të rrisim besimin e qytetarëve në sistemin e trajtimit të ankesave:

- Kemi administruar **2013** ankesa, të pranuar në mënyra të ndryshme;
- **33%** të tyre i orientuam për hetim penal në Departamentin e Hetimit;
- Pjesën e mbetur prej **67%** i kemi orientuar për hetim disiplinor Divizionin e Hetimeve të Brendshme dhe Verifikimin e të Kaluarës në kuadër të Policisë së Kosovës.

Ne u angazhuam në parandalimin dhe luftimin e krimit dhe keqmenaxhimit policor:

- Kemi hetuar **213** punonjës policor;
- Kemi ngritur **106** kallëzime penale ndaj të dyshuarve për vepra kriminale;
- Kemi arrestuar **38** punonjës dhe qytetarë nën dyshimin për përfshirje në krim;
- Kemi rekomanduar suspendimin e **85** punonjësve policor.

Përmes aktiviteteve tona ndihmuam në përmirësimin e policimit:

- Realizuam nëntë (**9**) inspektive të planifikuara dhe të jashtëzakonshme, me analiza të thella dhe përmbajtjesore lidhur me të gjitha fushat e menaxhimit;
- Kontrolluam **qindra** dosje administrative (penale, financiare, prokurimit, etj., dhe realizuam dhjetëra intervista;
- Rekomanduam avancimin e punës, efikasitetit dhe performancës përmes dhënies së **80** rekomandimeve;
- Verifikuam përmbushjen e rekomandimeve nga fushat e ndryshme të inspektuara më parë.

Ne u angazhuam në sensibilizimin e qytetarëve për të shprehur përkushtimin tonë për trajtimin e shqetësimeve të tyre:

- Publikuam mbi **60** komunikata,
- Ofruam informacione për medie në mbi **200** kërkesa të tyre;
- Realizuam shumë takime me qytetarë, forume të sigurisë, OJQ, institucione, etj.;
- Hartuam dokumente planifikuese dhe akte nënligjore.

5. MENAXHIMI I ANKESAVE

Departamenti i Menaxhimit të Ankesave (tutje si DMA) është ndarje organizative në kuadër të strukturës së organizimit të IPK-së, që ka për objekt të veprimtarisë: pranimin e të gjitha ankesave të qytetarëve, si dhe shqyrtimin dhe përcaktimin, se cilat nga to hetohen nga IPK dhe cilat do t'i referohen Policisë apo institucioneve përgjegjëse¹.

Qytetarët e vendit dhe ata të huaj mund të paraqesin ankesë në DMA lidhur me pretendimet e tyre se ndonjë nga pjesëtarët e Policisë ka kryer detyrat në kundërshtim me rregullat e sjelljes.

Ankesë konsiderohet çdo parashtrësë e drejtuar në IPK nga ndonjë individ ose grupi interesit, me të cilën shprehen shqetësimet lidhur me sjelljen devijante të punonjësve policorë apo kur parashtrësja ka të bëjë me standardet policore apo udhëzimet operative.

Detyrat dhe përgjegjësitë e DMA-së janë:

- të sigurojë realizimin e politikave e procedurave të organizatës në menaxhimin e ankesave dhe të informacionit të disponueshëm mbi dyshimet për përfshirje të punonjësve të Policisë në vepra të kundërligjshme;
- të sigurojë mbajtjen e evidencave/regjistrave për ankesat dhe mbi bazën e tyre nxjerrë statistika me të dhëna për raportime;
- të sigurojë që informatat që posedon IPK-ja mbahen/ruhen sipas ligjeve përkatëse;
- të sigurojë që ankesat trajtohen duke u bazuar në parimet e përcaktuara me Ligjin e IPK-së².

Bazuar në Rregulloren mbi organizimin e brendshëm, DMA-ja përbëhet nga dy divizione:

- Divizioni i Trajtimit të Ankesave;
- Divizioni i Administrimit të Lëndëve, dhe
- DMA ka të punësuar tetë (8) punonjës

¹ Neni 2 i Ligjit të IPK-së (Fushëveprimi).

² Neni 15 i Rregullores (MPB) nr. 01/2017 (Departamenti i Menaxhimit të Ankesave).

Përmbledhje ekzekutive mbi indikatorët e performancës

Numri i ankesave

- Gjithsej 2013 ankesa të pranuar gjatë vitit,
- Mesatarisht 167 ankesa në muaj në nivel Departamenti,
- Mesatarisht 39 ankesa për javë,
- Rreth 5.5 ankesa për ditë.

Trendi:

- Ngritje mbi 21.4 % të numrit të ankesave krahasuar me një vit më parë dhe rezulton si shifër më e larta në 10 vitet e fundit.

Mënyrat:

- 34.7 % janë pranuar përmes postës elektronike,
- 28.1 % janë pranuar nga qytetarët në formë fizike në IPK,
- 10.5 % përmes postës,
- 14.4 % përmes Policisë,
- 12.3 % përmes mënyrave tjera.

Gjinia:

- 79.6 % e ankuesve janë meshkuj,
- 11.6 % janë femra,
- 8.8 % e panjohur.

Trendi:

- Krahasuar me vitin e kaluar ankueset femra janë ngritur për 2-3%.

Etniciteti:

- 86.8 % e ankuesve janë shqiptar,
- 4.4 % e ankuesve janë nga pakicat, dhe
- 8.8 % e ankuesve janë të panjohur.

Ngarkesa mujore:

- Shtatori - muaji më i ngarkuar me 13.6 % të ankesave,
- Shkurti - muaji më pak i ngarkuar me 6.3 %.
- DRP-Prishtinë me 46.5% të ankesave,
- DRPK-Lindja më së paku ankesa.

Kualifikimi:

- 33.1 % e ankesave janë kualifikuar vepra penale (1/3),
- 66.1 % e ankesave janë kualifikuar shkelje disiplinore (2/3),
- 0.8 % të tjera.

Pranimi i ankesave

Departamenti i Menaxhimit të Ankesave gjatë vitit 2021 ka pranuar dhe administruar gjithsej 1.658 ankesa, prej të cilave 18 informata. Nëse shohim historikun e statistikave për numrin e ankesave për tri (3) vitet e fundit që lidhen me mandatet që dalin nga Ligji i IPK-së, shohim se viti i fundit ka shënuar shifrën më të lartë të numrit të ankesave të pranuar nga qytetarët e vendit. Në krahasim me vitin e kaluar është evidentuar ngritje e numrit të përgjithshëm të ankesave për 21.4 % apo 355 ankesa më shumë.

Këto statistika flasin për një vetëdijesim të qytetarëve si dhe një rritje të besueshmërisë së qytetarëve tek institucioni jonë, por kjo është edhe si rezultat i punës që bëjnë punonjësit e IPK-së, qoftë në rrafshin e përmbushjes së mandateve, apo në promovimin e vlerave tona dhe sensibilizimin e qytetarëve për punën që bëjmë. Edhe gjatë këtij viti, vendi ynë është përballuar me pandeminë e shkaktuar nga virusi Covid-19, dhe për këtë arsye qeveria e Republikës së Kosovës ka zbatuar disa masa për parandalimin e kësaj pandemie, siç janë vendosja e maskave, kufizimi i lirisë së lëvizjes dhe masa të tjera. Kjo ka ndikuar që një numër i qytetarëve të parashtrijë ankesa për shkak të gjobave të shqiptuara nga ana e Policisë së Kosovës, duke shprehur mospajtime dhe ankesa të ndryshme për veprimet e policisë. Pra, edhe kjo rrethanë është njëra prej arsyeve të ngritjes së numrit të ankesave.



Mënyrat e pranimi të ankesave

Sipas akteve ligjore dhe nënligjore të IPK-së, qytetarët kanë mundësi të ndryshme që të procedojnë ankesat e tyre. Nëse i referohemi statistikave të viteve të fundit, shihet se qytetarët më së shumti preferojnë që ankesat e tyre të dorëzojnë përmes postës elektronike. Dorëzimi i ankesave fizikisht në IPK si dhe dorëzimi përmes postës po ashtu janë ndër mënyrat më të shpeshta që preferojnë qytetarët.

Gjatë vitit 2021, rreth 34.7 % e ankesave të qytetarëve janë pranuar përmes postës elektronike të IPK-së, 28.1% e tyre janë pranuar fizikisht në IPK, 10.5 % kanë ardhur përmes postës dhe numri prej 14.5 % kanë ardhur nga Policia e Kosovës. Krahasuar me vitin e kaluar, ankesat që janë pranuar në formë elektronike kanë shënuar rritje për 283 ankesa më shumë, duke u preferuar më shumë nga qytetarët, për shkak edhe të përdorimit gjithnjë e më shumë të teknologjisë informative.

Mënyrat tjera të parashtrimit të ankesave janë preferuar më pak nga qytetarët dhe arrijnë në masën prej gjithsej 12%. Kutitë e ankesave janë një nga mënyrat që qytetarët nuk kanë preferuar të dorëzojnë asnjë ankesë gjatë këtij viti (shih tabelën nr. 1):

Tabela : Të dhëna përmblledhëse mbi numrin e ankesave dhe mënyrat e paraqitjes së tyre			
Nr.	Mënyrat e parashtrimit të ankesave në IPK	Numri	Përqindja
1	Ankesa të pranuar në formë elektronike	698	34.7 %
2	Ankesat e pranuar fizikisht në IPK	565	28.1 %
3	Ankesa të pranuar në zyrat rajonale të IPK-së	51	2.5 %
4	Përmes kutive të ankesave	0	/
5	Ankesa anonime	26	1.3 %
6	Informatat e pranuar në IPK	18	0.9 %
7	Ankesa (inicime) nga Departamenti Hetimeve	112	5.6 %
8	Ankesa të pranuar përmes postës	211	10.5 %
9	Inicime nga Departamenti i Menaxhimit të Ankesave	6	0.3 %
10	Ankesa të pranuar përmes institucioneve tjera	35	1.7 %
11	Ankesa të pranuar përmes Policisë së Kosovës	199	9.9 %
12	Inicime të brendshme nga Policia e Kosovës	92	4.6 %
	Gjithsej	2013	100%

Bazuar në të dhënat nga tabela më lartë, del se 1.687 ankesa (raste) apo 83.8% e ankesave janë pranuar nga mënyrat që ofron IPK-ja (renditja sipas numrave rendor 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9), derisa përmes Policisë së Kosovës janë pranuar 291 ankesa (raste dhe inicime të brendshme) apo 14.5% (renditja sipas numrave rendor 11 dhe 12), kurse 35 raste apo 17 % janë pranuar nga institucione tjera. Ankesa të pranuar nga zyrat rajonale të IPK janë si vijon: 28 ankesa të pranuar në Gjiçan, 18 ankesa të pranuar në Prizren dhe 5 ankesa të pranuar në Mitrovicën e Veriut.

Përkatësia gjinore e ankuesve

Sipas të dhënave të Departamentit të Menaxhimit të Ankesave, në vitin 2021, 1.603 ankesa janë adresuar nga persona të gjinisë mashkullore, derisa 233 ankesa janë nga persona të gjinisë femërore. Për pjesën e mbetur prej 177 ankesave, nuk ka qenë e mundur të dihet gjinia, për shkak të mënyrës që është përzgjedhur të ushtrohet ankesa dhe këtu hyjnë inicimet zyrtare nga DMA-ja, inicimet e brendshme, ankesat anonime si dhe ankesat që kanë ardhur nga institucionet tjera. Departamenti i Menaxhimit të Ankesave është interesuar të njihet me faktin se sa ka ndërruar raportin gjinor sa i përket personave që kanë adresuar ankesa në IPK. Me këtë rast, janë krahasuar trendet mbi raportin në mes të gjinive që kanë parashtruar ankesa në IPK për tre vitet e fundit. Vërehet se në vitin e fundit, përqindja e femrave që kanë ushtruar ankesë ka një ngritje të lehtë. Vlerësohet se kjo është rezultat i vetëdijesimit të personave të gjinisë femërore për të drejtën e tyre për të ushtruar ankesë kur vlerësojnë se kanë qenë subjekt që u janë shkelur të drejtat apo kur punonjësit policor në raport me to kanë kryer ndonjë shkelje (shih tabelën nr. 2):

Tabela : Të dhëna përmblledhëse mbi gjininë e ankuesve (2019-2021)							
Nr.	Ankuesit sipas gjinisë	2019	%	2020	%	2021	%
1	Meshkuj	1.090	75.7	1288	77.7	1603	79.6
2	Femra	155	10.8	149	9.0	233	11.6
3	E panjohur	194	13.5	221	13.3	177	8.8
	Gjithsej	1.439	100	1658	100	2013	100

Përkatësia etnike e ankuesve

Sipas të dhënave të Departamentit të Menaxhimit të Ankesave, në vitin 2021, 1.748 ankesa janë adresuar nga persona të përkatësisë shqiptare, 74 nga ta persona të përkatësisë serbe, 10 persona të përkatësisë boshnjake dhe 4 ankesa nga shtetas të huaj. Në krahasim me vitin e kaluar, kemi një rritje të numrit të ankesave nga ana e pjesëtarëve të komunitetit serb, pra janë 21 ankesa më shumë.

Në totalin prej 2013 ankesave, për 177 ankesa e pranuar në IPK, nuk dihet përkatësia e ankuesve dhe lidhen me iniciimet zyrtare nga DMA-ja, iniciimet e brendshme, ankesat anonime si dhe ankesat që kanë ardhur nga institucionet tjera. Po ashtu, Departamenti i Menaxhimit të Ankesave është interesuar të njihet me faktin se sa ka ndërruar raporti etnik sa i përket personave që kanë adresuar ankesa në IPK. Bazuar në këto të dhëna zyrtare, IPK gëzon besueshmëri në të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. Besohet se kësaj i ka kontribuar edhe organizimi i fushatave të vetëdijesimit qytetar në disa lokalitete ku jetojnë pjesëtarë të pakicave, të cilët kanë pasur mundësi të njihen me punën që bën institucioni jonë dhe mundësitë që ofron bashkëpunimi në trajtimin e ankesave të tyre. Me këtë rast, janë analizuar dhe krahasuar trendet mbi raportin në mes të personave sipas etnive që kanë ushtruar ankesa në IPK për 3 vitet e fundit (shih tabelën nr.3) :

Tabela nr. 3-Të dhëna përmbledhëse mbi përkatësinë etnike të ankuesve (2019-2021)							
Nr.	Ankuesit sipas gjinisë	2019	%	2020	%	2021	%
1	Shqiptar	1.149	79.8	1379	83.2	1748	86.8
2	Serb	74	5.1	51	3.1	74	3.7
3	Turq	2	0.1	0	0.0	0	0.0
4	Boshnjak	13	1.0	4	0.2	10	0.5
5	RAE	2	0.1	0	0.0	0	0.0
6	Të tjerë të huaj	5	0.4	3	0.2	4	0.2
7	E panjohur	194	13.5	221	13.3	177	8.8
	Gjithsej	1.439	100	1.658	100	2013	100

Ngarkesa mujore me ankesa

Muaji më i ngarkuar me numër të ankesave përgjatë vitit 2021 ka qenë muaji shtator, në të cilin janë regjistruar 274 ankesa apo 13.6 % e numrit të përgjithshëm të ankesave të pranuar gjatë vitit. Muaji shkurt ka qenë muaji më pak i ngarkuar me më së paku ankesa të pranuar gjatë këtij viti, ku numri ishte 127 ankesa apo 6.3 % e numrit të përgjithshëm të ankesave (shih tabelën si më poshtë):

Tabela : Të dhëna përmblledhëse mbi shpërndarjen e ankesave sipas muajve (2019-2021)							
Nr.	Muaji	2019	%	2020	%	2021	%
1	Janar	87	6.05	108	6.51	137	6.8
2	Shkurt	103	7.16	123	7.42	127	6.3
3	Mars	113	7.85	129	7.78	158	7.8
4	Prill	121	8.41	84	5.07	166	8.2
5	Maj	101	7.02	102	6.15	148	7.4
6	Qershor	112	7.78	125	7.54	187	9.3
7	Korrik	134	9.31	120	7.24	188	9.3
8	Gusht	139	9.66	159	9.59	179	8.9
9	Shtator	120	8.34	172	10.37	274	13.6
10	Tetor	153	10.63	176	10.62	131	6.5
11	Nëntor	138	9.59	162	9.77	167	8.3
12	Dhjetor	118	8.20	198	11.94	151	7.5
	Gjithsej	1.439	100	1.658	100	2013	100

Numri i ankesave në raport me drejtoritë rajonale

Të dhënat e administruara nga Divizioni i Administrimit të Lëndëve i Departamentit të Menaxhimit të Ankesave mundësojnë të kuptojmë edhe drejtoritë policore për punonjësit e të cilave ka pasur ankesa të qytetarëve.

Sipas të dhënave, ankesat më të shumta janë adresuar për punonjësit e Drejtorisë Rajonale të Prishtinës dhe arrijnë në 46.5 % të numrit të përgjithshëm të ankesave. Ndërsa më pak të atakuar mbesin Drejtoritë Rajonale të Policisë Kufitare Lindja 0.3 % (shih tabelën si më poshtë) :

Tabela : Të dhëna përmblledhëse mbi shpërndarjen e ankesave sipas rajoneve policore gjatë			
Nr.	Drejtoritë	Numri	%
1	DRP-Prishtinë	936	46.5
2	DRP-Pejë	168	8.3
3	DRP-Ferizaj	160	7.9
4	DRP-Prizren	181	9.0
5	DRP-Gjilan	177	8.8
6	DRP-Mitrovicë Jugu	162	8.0
7	DRP-Mitrovicë Veriu	58	2.9
8	DRP-Gjakovë	136	6.8
9	DRPK-Veriu	14	0.7
10	DRPK-Lindja	7	0.3
11	DRPK-Perëndimi	14	0.7
12	I palokalizuar	0	0.0
	Gjithsej	2013	100


Kualifikimi i ankesave

Gjatë vitit 2021, 667 ankesa apo 33.1 % të numrit të përgjithshëm të ankesave të pranura në IPK janë kualifikuar si ankesa që përmbajnë elemente të përfshirjes së punonjësve policor në vepra penale. Këto ankesa janë proceduar në Departamentin e Hetimeve të IPK-së për trajtim/hetim të mëtejshëm.

Numri prej 1331 ankesave apo 66.1 % e numrit të përgjithshëm të ankesave, të pranura në IPK janë kualifikuar se përmbajnë elemente të përfshirjes së punonjësve policor në shkelje disiplinore, dhe të njëjtat janë proceduar në Divizionin e Hetimeve të Brendshme dhe Verifikimin e të Kaluarës në kuadër të Policisë së Kosovës.

Gjatë këtij viti janë evidentuar 10 raste kur ankesat janë proceduar në institucionet tjera përgjegjëse (0.5 %), si dhe 4 raste apo 0.2 % janë evidentuar që ankesat të jenë proceduar në Departamentin e Hetimeve për t'u trajtuar për shkelje disiplinore konform mandatit ligjor. (shih diagramin nr.2 si më poshtë).

Sipas analizave të bëra, afërsisht 1/3 e ankesave të pranura janë kualifikuar se përmbajnë elemente të veprave penale, derisa 2/3 e ankesave janë kualifikuar se përmbajnë elemente të shkeljeve disiplinore (shih diagramin nr.2 si më poshtë):



6. HETIMET PENALE

Departamenti i Hetimeve (D.H) është një ndarje organizative në kuadër të strukturës së organizimit të IPK-së dhe funksionon që nga viti 2007.

Objektiv i veprimtarisë së Departamentit të Hetimeve është: parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj. Hetimi i incidenteve disiplinore të profilit të lartë, ku përfshihen të gjithë punonjësit e Policisë; Hetimi i të gjitha shkeljeve disiplinore të supozuara të zyrtarëve policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve policorë të nivelit të lartë ekzekutive etj. ³

Departamenti i Hetimeve është një ndarje organizative në kuadër të strukturës së organizimit të IPK-së dhe funksionon që nga viti 2007.

Objektivë e veprimtarisë së Departamentit të Hetimeve është: parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj. Hetimi i incidenteve disiplinore të profilit të lartë, ku përfshihen të gjithë punonjësit e Policisë etj. ⁴

Përgjegjësitë (detyrat) e Departamentit janë: se kryen hetime penale si dhe disiplinore ndaj punonjësve të Policisë, zbaton masat e fshehta hetimore në funksion të fushëveprimit, të autorizuar nga autoriteti kompetent. Zbaton metoda apo teknika të ligjshme për të zhvilluar kapacitetin proaktiv në ruajtjen e etikës dhe integritetit, në kuadër të standardeve të larta profesionale policore. Bashkëpunon me Prokurorinë në fushën e hetimeve dhe shfrytëzon burime të ligjshme të informacionit për nevoja operative. Nxjerrë raporte mbi rrjedhën e hetimeve të zhvilluara dhe kallëzime penale, ndërmerr veprime të nevojshme ligjore për të siguruar dhe vlerësuar informatat inteligjente. Siguron mbështetje teknike në funksion të hetimeve (përdorë pajisje teknike në funksion të realizimit të masave të veçanta, siguron dhe trajton dëshmi nga vendngjarja)⁵.

Hetuesit e zhvillojnë aktivitetin e tyre në tetë (8) divizione. Departamenti ka të punësuar 46 punonjës (Udhëheqës i Departamentit, udhëheqës të divizioneve dhe hetues).

DEPARTAMENTI I HETIMEVE

D.H u angazhuan në parandalimin dhe luftimin e krimit dhe keq menaxhimit policor:

- Kemi hetuar 213 punonjës policor;
- Kemi ngritur 106 kallëzime penale ndaj të dyshuarve për vepra kriminale;
- Kemi arrestuar 38 punonjës dhe qytetarë me dyshimin për përfshirje në aktivitete të kundërligjshme;
- Kemi rekomanduar suspendimin e 85 punonjësve policorë. Policorë.


³ Neni 2 i Ligjit të IPK-së (Fushëveprimi).

⁴ Neni 2 i Ligjit të IPK-së (Fushëveprimi).

⁵ Neni 6 i Rregullores (MPB) nr.01/2017 (Departamenti i Hetimeve).

Raporti përmbledhës për hetime penale përmban aktivitete të realizuara në suaza të detyrave dhe përgjegjësi që rrjedhin nga dispozitat e përcaktuara në Ligjin për IPK, në veçanti për Departamentin e Hetimit, si dhe të dhënat që posedon dhe të dhënat e gjeneruara. Bazuar në të dhënat nga evidencat zyrtare, gjatë vitit 2021, subjekti hetimit nga IPK kanë qenë gjithsej 213 punonjës policor, shprehur në përqindje vetëm 2.3% e numrit të përgjithshëm të punonjësve policorë janë hetuar me dyshimin se kanë kryer vepra penale.

Diagrami :Numri i të hetuarve 2019-2021



Viti 2021 konsiderohet një vit i suksesshëm për DH-në bazuar në të dhënat lidhur me numrin e rasteve të trajtuara, numrin kallëzimeve penale, numrin e të arrestuarve, të suspenduarve etj.

Në vitin 2021, D.H-ja ka pranuar 667 raste përmes DMA-së, ndërsa të bartura nga viti 2020 në vitin 2021 kanë qenë gjithsej 235 raste të cilat janë konsideruar si raste nën hetim paraprak.

Departamenti i Hetimeve ka trajtuar gjithsej: 902 raste duke përfshirë rastet e bartura nga viti paraprak si dhe rastet e pranuar në këtë vit (shih tabelën nr.1 si më poshtë).

Tabela : Kategorizimi i rasteve dhe hapat procedural	
Gjithsej në punë	902
Të regjistruara (2021)	667
Të bartura nga viti paraprak	235

Sa i përket 235 rasteve që janë bartur nga viti 2020 për në vitin 2021, si raste në hetim paraprak, trajtimi i tyre është bërë si në vijim:


- 91 raste (38.8%) janë dërguar në DHBVK për hetim të mëtejshëm disiplinor;
- 18 raste (7.6%) janë dorëzuar në Prokurorin e Shtetit;
- 12 raste (5.1%) të përfunduara nga DIA në fazën e informatave;
- 114 raste(48.5%) janë në proces të hetimit paraprak dhe barten në vitin 2022.

Nga 667 raste të pranuar në vitin 2021 pas trajtimit të tyre nën hetim paraprak, në mungesë të elementeve të veprës penale apo dyshimit të arsyeshëm, 349 raste janë proceduar në DHBVK -PK për hetim të mëtejshëm administrativo - disiplinor, ndërsa 163 raste pas hetimeve paraprake janë proceduar nën hetim penal, 11 raste janë trajtuar në aspektin disiplinor bazuar në ligjin për IPK⁶. Totali prej 367 raste kanë mbetur në proces hetimor të bartura në vitin 2022 nga të gjitha vitet paraprake.

⁶ LIGJI Nr. 03/L-231, Neni 2, paragrafi 1.3, 1.4 dhe 14.5

IPK në vitin 2021 ka regjistruar 163 raste me numër penal përderisa në Prokurorinë e Shtetit ka proceduar 164 raste (duke llogaritur edhe disa nga rastet e bartura nga vitet paraprake), ndërsa 24 raste kanë mbetur në proces (janë bartur në vitin 2022)


Diagrami në vazhdim pasqyron statusin e rasteve penale të trajtuara si dhe trendet e krahasuara me dy vitet paraprake:



IPK gjatë vitit 2021 ka proceduar me kallëzim penal në Prokurorinë e Shtetit gjithsej 106 raste, me raport të veçantë gjithsej 54 raste, kurse me raport informues në prokurori janë proceduar 04 raste.

Bazuar në diagramin në vijim shihet se numri i kallëzimeve penale është në rritje të lehtë në vitin 2021, krahasuar me dy vitet paraprake, gjithashtu shihet një ngritje e lehtë e dërgimit të rasteve me raport të veçantë, ndërsa ka rënie të dukshme të dërgimit të rasteve me raport informues⁷.


⁷ Arsytet e trendit të rritjes në vitin 2019 është se në këtë vit janë proceduar me raporte informuese sipas udhëzimeve të Prokurorisë së Shtetit rasti i ashtuquajtur “invalidët e luftës” ku të hetuar kanë qenë 141 punonjës të PK-së.



Si rezultat i proceseve hetimore dhe angazhimeve të personelit hetimor, gjithmonë kur janë plotësuar kushtet ligjore, DH-ja ka kryer arrestimet e të dyshuarve për përfshirje në veprimtari penale, duke vënë në zbatim dispozitat e përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës. Bazuar në dispozitat e parapara të ligjit nr. 03/L-231 nenin 17 paragrafin 12, konsideron DH-ja **kur e** se është në interes të hetimeve, i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë formën e veprimit që mund përfshijë, por nuk kufizohet në llojet e suspendimit me pagesë apo transferimin e punonjësve policor.


IPK-ja gjatë vitit 2021, ka realizuar gjithsej 34 arrestime të punonjësve të PK-së dhe 04 **qytetarë** të dyshuar (të cilët kanë qenë të përfshirë në veprimtari penale në rastet ku janë hetuar punonjësit e PK-së), si dhe ka rekomanduar 85 suspendime dhe 6 transferime në interes të hetimeve.

Në diagramin në vijim janë paraqitur numri i zyrtarëve të arrestuar, suspenduar dhe transferuar për tre vitet e fundit.



Duke ju referuar rasteve penale të trajtuara nga IPK në koordinim me Prokurorin e Shtetit gjatë vitit 2021, pesë (5) veprat penale më të shpeshta që janë hetuar gjatë vitit 2021 janë të pasqyruara në diagramin si në vijim:

Diagrami : Pesë veprat penale më të shpeshta të hetuara nga IPK në 2021




Gjatë tre viteve të fundit (2019-2021), pothuajse të njëjtat vepra kanë prirë në listën e pesë veprave penale. Ka trend të ngritjes së vazhdueshme për veprat penale; “Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike”, “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “Lëndimi i lehtë trupor”, “Kanosje” dhe “Dhuna në familje”.

Të dhënat zyrtare tregojnë se në vitin 2021 ka trend të rritjes së lehtë tek veprat penale “Dhuna në familje” dhe “Kanosja”, ndërsa kemi ngritje të ndjeshme tek vepra penale “Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike”. Në veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, kemi një rënie minimale, ndërsa tek vepra penale “Lëndim i lehtë trupore” kemi një rënie të lehtë.

Të dhënat e lartëcekura janë të paraqitura në diagramin si më poshtë:

Diagrami : Kategorizimi i pesë (5) veprave më të shpeshta penale



Gjatë vitit 2021, DH ka qenë e përkushtuar në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi, në parandalimin si dhe luftimin e veprimtarive penale të kryer nga punonjësit e Policisë së Kosovës dhe qytetarëve të përfshirë me punonjësit e PK së, e me theks të veçantë në luftimin e veprimtarisë

korruptive. Pasqyra e veprave me elemente të korrupsionit zyrtar dhe kundër detyrës zyrtare krahasuar edhe me dy vitet paraprake është paraqitur në tabelën në vijim:

Tabela : Pasqyra e veprave me elemente të korrupsionit zyrtar dhe kundër detyrës zyrtare				
Nr.	Lloji i veprës penale	2019	2020	2021
1	Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	26	28	27
2	Falsifikim i dokumentit zyrtar	1	0	01
3	Marrje e ryshfetit	4	3	01
4	Ushtrimi ndikimit	1	1	02
5	Zbulimi fshehtësisë zyrtare	1	0	02
5	Dhënie e ryshfetit	0	0	0
6	Përvetësim në detyrë	1	0	0
7	Konflikti interesit	1	0	0
8	Keqpërdorimi informatës zyrtare	1	0	0
	Gjithsej	36	32	33

Tabela nr. 3 në vijim pasqyron të dhënat e veprave penale të trajtuara nga IPK gjatë vitit 2021, të ndara në kapituj duke ju referuar Kodit Penal të Republikës së Kosovës:

Tabela : Lloji i veprave penale	Nr. i veprave
Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës (XIV)	
Neni 140 Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare	1
Neni 141 Nxitja e përçarjes dhe mosdurimit	1
Veprat penale kundër jetës dhe trupit(XVI)	
Neni 173 Vrasja e rëndë (Tantativa)	1
Neni 181 Kanosja	13
Neni 182 Ngacmimi	4
Neni 183 Ngacmim Seksual	1
Neni 184 Sulmi	4
Neni 185 Lëndimi i lehtë trupor	23
Neni 186 Lëndimi i rëndë trupor	5
Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut (XVII)	
Neni 191 Rrëmbimi	1
Neni 192 Shtrëngimi	1
Neni 193 Privimi i kundërligjshëm i lirisë	1
Neni 198 Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike	33
Neni 202 Fotografimet dhe incizimet tjera të paautorizuar	1
Neni 203 Shkelja e urdhërave për masat e fshehura ose teknike të vëzhgimit ose hetimit	1
Veprat penale kundër integriteti seksual (XX)	
Neni 227 Dhunimi	1
Neni 229 Sulm Seksual	1
Veprat penale kundër martesës dhe familjes (XXI)	

Neni 248 Dhuna në familje	12
Veprat penale të narkotikëve (XXIII)	
Neni 267 Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve substancë psikotrope dhe analoge	1
Neni 269 Posedimi i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge	1
Veprat penale kundër pasurisë (XXVI)	
Neni 313 Vjedhja	1
Neni 315 Vjedhja e rëndë	1
Neni 321 Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë	3
Neni 322 Zjarrëvënia	2
Neni 323 Mashtrimi	1
Neni 331 Fajdeja	2
Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë (XXVIII)	
Neni 356 Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm	3
Neni 359 Ndërtimi pa leje	1
Veprat penale të armëve (XXVIX)	
Neni 366 Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve	3
Neni 367 Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm	2
Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik (XXX)	
Neni 370 Rrezikimi i trafikut publik	5
Neni 371 Ngasja në gjendje të pa aftë apo të dehur	4
Veprat penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike (XXXI)	
Neni 378 Moslajmërimi i veprave penale apo kryesve të tyre	5
Neni 380 Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale	1
Neni 382 Lajmërimi apo kallëzimi i rremë	2
Neni 384 Deklarimet e rreme	2
Neni 389 Manipulimi me prova	1
Neni 390 Falsifikimi i dokumentit	1
Veprat penale kundër rendit publik (XXXII)	
Neni 401 Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare	1
Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare (XXXIII)	
Neni 414 Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	27
Neni 421 Marrja e ryshfetit	1
Neni 424 Ushtrimi i ndikimit	2
Neni 426 Zbulimi i fshehtësisë zyrtare	2
Neni 427 Falsifikimi i dokumentit zyrtar	1

Policia e Kosovës ka gjithsej 9092 punonjës, nga të cilët 8124 janë zyrtarë policorë me grada të ndryshme, ndërsa personel civil - pa autorizim policor janë 968.

Në tabelat (në vazhdim pasqyrohen të dhënat lidhur me 213 punonjësit policor të hetuar nga IPK-të ndarë sipas gradave të zyrtarëve që janë hetuar si dhe krahasimi me dy vitet paraprake.

Tabela : Raporti në mes të numrit të përgjithshëm të punonjësve dhe atyre të hetuar									
Numri	Kolonel	N/kolonel	Major	Kapiten	Toger	Rreshter	Polic	Polic I ri	Shërbyes civil
Numri i punonjësve	32	52	91	164	355	950	5814	666	968
Numri i të hetuarve nga IPK	0	2	3	2	6	19	172	0	9

Tabela : Pasqyra e të hetuarve nga Departamenti i Hetimeve të IPK-së (2019-2021)									
Numri i të hetuarve nga IPK-ja sipas gradave	Kolonel	N/kolonel	Major	Kapiten	Toger	Rreshter	Polic	Polic I ri	Shërbyes civil
Viti 2019	2	6	5	12	13	57	268	1	13
Viti 2020	1	4	7	4	10	27	147	1	7
Viti 2021	0	2	3	2	6	19	172	0	9

Policia në bazë të strukturës organizative aktuale përbëhet nga Drejtoria e përgjithshme dhe pesë (5) departamente, ku numrin më të madh të personelit prej 6634 punonjësve e ka Departamenti për Operacione.

Ky Departament përfshin tre divizione (Divizioni për Siguri Publike, Divizionin i Njësive të Specializuara dhe Divizioni për Komunikacion Rrugor), tetë (8) drejtori rajonale policore dhe 41 stacione policore. Bazuar në këtë shpërndarje të personelit policor edhe numri më i madh i zyrtarëve të hetuar nga IPK-ja është pikërisht nga Departamenti për Operacione.

Tabela në vazhdim pasqyron numrin e punonjësve policor të hetuar nga IPK, të ndarë në strukturën organizative policore. Në gjithë departamentet ka ulje të numrit të punonjësve që kanë qenë subjekt hetimi në IPK, me përjashtim në Departamentin për Operacione ka ngritje të lehtë të numrit të punonjësve të hetuar nga IPK -ja.


Të gjitha të dhënat e lartcekura janë paraqitur në tabelën si në vijim:

Tabela	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Departamenti i Përgjithshëm i Policisë	0	3	1
Zv. drejtorja e përgjithshme për operative	0	4	0
Zv. drejtorja e përgjithshme për resurse	0	3	0
Departamenti për Operacione	256	164	195
Departamenti për Kufi	91	25	17
Departamenti për Shërbime Mbështetëse	3	3	0
Departamenti për hetime	21	6	0
Departamenti i Burimeve Njerëzore	5	0	0


Bazuar në atë se Departamenti për Operacione përbëhet nga tre (3) divizione, të dhënat e paraqitura në diagram tregojnë pasqyrën e shpërndarjes së 194 punonjësve policor të hetuar në Departamentin për Operacione.

Pjesa dërmuese e të hetuarve është shpërndarë në Divizionin për Siguri Publike, ku janë strukturuar drejtoritë rajonale dhe stacionet. Bazuar në të dhënat e IPK-së vërehet një ngritje të numrit të të hetuarve për 8% krahasuar me vitin paraprak ose për 13 punonjës më shumë.


Të dhënat e lartcekura janë paraqitur në diagramin në vijim:



Diagrami në vazhdim jep pasqyrën e shpërndarjes së të hetuarve në tetë (8) Drejtoritë Rajonale Policore. Gjatë vitit 2021 janë hetuar 165 punonjës policor të angazhuar në këto drejtori. Diagrami pasqyron, se DRP - Prishtinë prinë nga të gjitha drejtoritë me numrin më madh të të hetuarve nga radhët e saj duke pasur edhe numrin më të madh të punonjësve të shpërndarë në stacione policore. Ngritje të theksuar të numrit të të hetuarve krahasuar me vitin paraprak ka shënuar DRP -Peja, DRP- Prizren dhe DRP Mitrovicë Jug, ndërsa në Drejtoritë tjera ka rënie krahasuar me vitin paraprak.



Po ashtu, edhe Policia Kufitare në organizimin e saj strukturor është e përshkallëzuar edhe në nivelin e tri Drejtorive Rajonale të Policisë Kufitare dhe Aeroporti i Prishtinës. Diagrami në vazhdim jep pasqyrën e shpërndarjes së 16 punonjësve të Policisë Kufitare të hetuar nga IPK-ja krahasuar edhe me dy vite paraprake.



Bazuar në fushëveprimin ligjor të IPK-së, sa i përket incidenteve të profilit të lartë dhe shkeljeve disiplinore të nivelit të lartë të menaxhimit dhe atyre të nivelit të lartë ekzekutiv, gjatë vitit 2021, DH-ja ka regjistruar një (1) rast me karakter disiplinor që lidhet me shkelje disiplinore të profilit të lartë, e po ashtu nën hetim paraprak për shkelje të supozuara disiplinore janë trajtuar dhjetë 10 ankesa/raste.

Tutje, në kuadër të fushë veprimtarisë dhe gjatë përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësi në Departamentin e Hetimeve, janë realizuar edhe shumë aktivitete tjera si zhvillimi i hetimeve proaktive me masa të fshehta hetimore, dalja në vend ngjarje për incidentet të shkaktuar nga punonjësit policor e jo vetëm etj. Po ashtu në këtë periudhë kohore një pjesë dërmues e stafit të DH-së kanë qenë të angazhuar në Planet Operativ të IPK-së, "Monitorimi i respektimit të vendimeve mbi zbatimin e masave parandaluese kundër përhapjes së Covid-19", ku ky Plan Operative ka qenë në implementim vazhdueshëm për periudha të ndryshme kohore në vitin 2021.

7. INSPEKTIMET E STRUKTURAVE DHE FUNKSIONEVE POLICORE

Departamenti i Inspektimit është një ndarje organizative në kuadër të strukturës së organizimit të IPK-së dhe funksionon nga viti 2006. Objekt i veprimtarisë së Departamentit është inspektimi i strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës për të siguruar llogaridhënie, efektivitet e efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore dhe procedurave standarde të operimit në fuqi⁸.

Duke qenë pjesë integrale e strukturës së organizatës, Departamenti i Inspektimit në përmbushje të mandatit ushtron mbikëqyrje të vazhdueshme policore, përmes realizimit të inspektimeve (të rregullta dhe të jashtëzakonshme). Inspektimet janë vlerësime të mënyrës së kryerjes së detyrave nga Policia e Kosovës, duke siguruar arritjen e qëllimeve në përputhje me legjislacionin dhe standardet e kërkuara⁹.

Bazuar në Rregulloren (MPB) nr. 01/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në IPK, përgjegjësitë dhe detyrat e Departamentit të Inspektimit janë: nxjerrja e Planit Vjetor të Inspektimit në fushat e menaxhimit policor të përcaktuar me Ligjin për IPK-në, kryerja e inspektimeve në Polici me iniciativë të vetën ose me urdhër të Ministrit, sigurimi i informatave nga fushat menaxheriale përmes metodave të autorizuar të marrjes dhe sigurimit të tyre, analizimi dhe vlerësimi i kryerjes së detyrave nga struktura policore, hartimi i raporteve të inspektimit të bazuara në standardet e raportimit duke përfshirë në to gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet¹⁰.

Inspektorët udhëhiqen nga parimet, përfshirë atë të profesionalizmit, objektivitetit, paanshmërisë politike dhe mosdiskriminimit. Inspektorët policor zhvillojnë aktivitetin e tyre në dy divizione: Divizionin për Analizë, Planifikim dhe Cilësi, si dhe në Divizionin e Inspektimit dhe Raportimit. Momentalisht në funksion të IPK-së, Departamenti i Inspektimit ka të angazhuar 13 punonjës me njohuri dhe aftësi të duhura në fushat e kontrollit policor që janë në kompetencë për inspektim.

DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT

Përmes aktiviteteve tona ndihmuam në përmirësimin policimit:

- Realizuar nëntë (9) inspektime të rregullta dhe të jashtëzakonshme, me analiza të thella dhe përmbajtësore lidhur me të gjitha fushat e menaxhimit;
- Kontrolluar qindra dosje administrative (penale, financiare, të prokurimit etj) dhe realizuar me dhjetëra intervista;
- Rekomanduar avansimin e punës, efikasitetit dhe performancës përmes dhënies së 80 rekomandimeve;
- Verifikuar përmbushjen e rekomandimeve nga fushat e ndryshme të inspektuara më parë.
- Ne punojmë në mënyrë të hapur dhe transparente dhe jemi të përgjegjshëm për atë që bëjmë.

⁸ Neni 2 i Ligjit të IPK-së (Fushëveprimi).

⁹ Neni 4 i Ligjit të IPK-së (Përkufizimet).

¹⁰ Neni 18 i Rregullores (Departamenti i Inspektimit).

Viti 2021 ishte një vit tjetër produktiv për Departamentin e Inspektimit (DI), me gjithë sfidat evidente që kanë vështirësuar arritjen e objektivave. Sidoqoftë, me gjithë faktin se Pandemia Covid-19 ka prekur vendin tonë, dhe se Qeveria ka vendosur një numër masash parandaluese, në rrethana të jashtëzakonshme me mundësi dhe fushëveprim të kufizuar, Departamenti falë angazhimit të inspektorëve ka realizuar katër (4) raporte të rëndësishme të dala nga inspektimet e rregullta dhe pesë (5) raporte të tjera nga inspektimet e jashtëzakonshme. Ky është tejkalim i pritjeve, kur kemi parasysh se një vit më parë janë realizuar gjithsej shtatë (7) inspektime. Raportet kanë rezultuar me gjithsej 80 rekomandime, shumë më shumë se në vitin paraprak ku janë dhënë 46 sosh.

Departamenti vazhdon të përmbushë mandatin në përputhje me vlerat, duke vepruar në mënyrë të pavarur dhe të përqendruar në nevojat e përdoruesve të shërbimeve duke punuar në mënyrë të hapur dhe transparente dhe duke qenë të përgjegjshëm.

Në përmbushje të misionit ligjor, DI ka qenë e përkushtuar në zhvillimin e një policie të përgjegjshme, demokratike dhe profesionale. Këto vlera forcojnë besimin e publikut në policinë e vendit.

Për të realizuar objektivat tona, DI kryen inspektime të informuara, të udhëhequra nga provat, duke kërkuar përtej kufijve për të identifikuar qasjet shqyrtuese dhe praktikat e mira që mund të adoptohen.

Përgjatë periudhës afatmesme kohore 2019 – 2021, DI është orientuar nga Strategjia e IPK-së dhe Plani i saj i Veprimit, nga i cili burojnë edhe planet vjetore të punës. Këto dokumente që janë në frymën e Programit qeveritar, inspektimin e shohin si mekanizëm të duhur në drejtim të parandalimit të korrupsionit dhe keqpërdorimit në radhët e punonjësve të Policisë.

Planet bazohen në analiza dhe risqet e identifikuar dhe përmes tyre realizohen inspektime që trajtojnë fusha me interes, fusha këto që mund të prodhojnë efekte negative në zhvillimin e duhur policor. Dhe lidhur me këtë, DI ka kompetencën dhe përgatitjen e personelit për të kontrolluar mbarëvajtjen e proceseve brenda Policisë.

DI ka mbetur e përkushtuar për përmirësimet e vazhdueshme, duke rishikuar kornizën inspektuese, politikat, procedurat, si dhe duke investuar në fuqinë punëtore. Sa i përket kësaj të fundit, viteve të fundit DI ka pasur parasysh edhe profilizimin e personelit në fusha të caktuara, duke bërë që fushat e inspektimeve t'ua besojnë inspektorëve, varësisht prej afiniteteve të tyre.

Duhet potencuar rolin e partnerëve ndërkombëtar që vazhdojnë të mbështesin Departamentin e Inspektimit me programe trajnuese për zhvillim të vazhdueshëm profesional e vizita studimore në vendet evropiane dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

AKTIVITETET OPERATIVE BRENDË PROCESIVE TË INSPEKTIMIT

Inspektimet kontribuojnë në ngritjen e përgjegjësisë për zbatimin e legjislacionit, përdorimin e drejtë të burimeve, ofrimin e shërbimeve cilësore, marrjen e veprimeve korrigjuese, lehtësimin e vendimmarrjes dhe përmirësimin e transparencës ndaj publikut. Inspektimi identifikon mangësi në performancën policore të përcaktuar me legjislacionin përkatës dhe standardet e kërkuara.

Deri në konstatimin e një gjendjeje, nevojitet që të kalohet nëpër disa faza. Kjo bën të kuptohet se inspektimi është proces që domosdo kalon nga një fazë në tjetrën. Procesi i inspektimit nënkupton sistemin administrativ që duhet të përdoret nga IPK-ja për të zhvilluar inspekte në Polici, për të garantuar se strukturat dhe personeli i saj operojnë në përputhje me ligjet, rregulloret, parimet dhe procedurat e përcaktuara¹¹. Për të pasqyruar hapat nëpër të cilët kalon inspektimi, pasqyrojmë aktivitetet sipas fazave të procesit inspektues.

Planifikimi

Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta

Faza e planifikimit ka përfshirë nxjerrjen e planit vjetor të inspektimeve dhe programeve të punës në frymën e Planit Strategjik Zhvillimor. Departamenti i Inspektimit më parë ka qenë pjesë aktive e procesit të nxjerrjes së këtij Plani, që parasheh aktivitetet inspektuese drejt zbatimit të mekanizmit parandalues të korrupsionit e keq-menaxhimit në radhët e Policisë. Plani i Veprimit ka paraparë kryerjen e minimum pesë inspektimeve të rregullta dhe sipas nevojave a rrethanave të krijuara, kryerjen edhe atyre të jashtëzakonshme.

Në fillim të vitit 2021, Divizioni për Analizë, Planifikim e Cilësi ka përmbyllur procesin e nxjerrjes së Planit Vjetor të Inspektimeve të Rregullta për vitin 2021. Ky Plan ka identifikuar fusha me risk dhe ka marrë parasysh politikat e realizimit të inspektimeve të rregullta dy-tre vjeçare për fushat e njëjta. Departamenti u ka ofruar disa akterëve (Ministrisë, Policisë, IPK-së) të bëhen pjesë e procesit për të siguruar nxjerrjen e një Plani cilësor që adreson fushat me rëndësi.

Siç parashihet në nenin 25, paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L-231 të IPK-së, brenda tremujorit të parë të vitit, Udhëheqësi i Departamentit të Inspektimit i ka dorëzuar Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së, Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta (2021). Ky autoritet më 20 janar 2021 ka miratuar Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta¹². Plani ka marrë në konsideratë obligimet që dalin nga Plani Strategjik Zhvillimor, rëndësinë e programeve, risqet e identifikuar, rezultatet e inspektimeve të kaluara, kapacitetet njerëzore të Departamentit të Inspektimit dhe çështjet e pa-trajtuara.

Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta ka paraparë inspekte në këto fusha të menaxhimit:

- (a) Menaxhimi i patrullimeve dhe sigurisë në rrugë;
- (b) Monitorimi i besueshmërisë dhe kënaqshmërisë së publikut me Policinë e Kosovës;

¹¹ Neni 4 i Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 21/2015 për Inspekte në Policinë e Kosovës.

¹² Departamenti i Inspektimit, *Plan Vjetor i Inspektimeve të Rregullta (2021)*, nr. 04-052-107/10, datë 21.01.21.

- (c) Menaxhimi i hetimit dhe zbulimit të krimit;
- (d) Menaxhimi i kontratave të lidhura me operatorët ekonomik;
- (e) Menaxhimi i Sistemit Informativ të Policisë së Kosovës.

Për shkak të rrethanave të krijuara si rezultat i pandemisë, një (1) nga inspektimet e planifikuara është shtyrë për vitin pasues, meqenëse shumë çështje të lidhura me të janë prekur në disa prej inspektimeve tjera. Duhet përmendur faktin se kapacitetet inspektuese janë fokusuar veç tjerash edhe në kërkesat e dala nga Ministri dhe Kryeshefi Ekzekutiv për realizimin edhe të pesë (5) inspektimeve të jashtëzakonshme, si:

- (a) Trajtimi i personave të ndaluar përkohësisht në Stacionin Policor të Ferizajt;
- (b) Vlerësimi i performancës së stacioneve policore në Obiliç, Podujevë dhe Skënderaj;
- (c) Menaxhimi, funksionimi dhe aktivitetet hetimore të Drejtorisë së Hetimit të Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit;
- (d) Kryerja e detyrave gjatë trajtimit policor të rasteve të dhunës në familje;
- (e) Vlerësimi i performancës policore në realizimin e urdhërave të gjykatave.

Programet e punës inspektuese

Mbi bazën e Planit Vjetor të Inspektimeve janë nxjerrë Programet e punës inspektuese. Para se të hartohen Programet e tilla sipas kornizës kohore të përcaktuar, Divizioni për Analizë, Planifikim e Cilësi ka kryer parastudim të fushave përkatëse, duke synuar të njohë më mirë veprimtarinë e organizatës policore, të studiojë planet e punës dhe legjislacionin, dokumentet mbi organizimin, burimet policore, aktivitetet dhe raportet policore.

Programet e punës inspektuese janë hartuar nga Divizioni për Analizë, Planifikim dhe Cilësi, janë propozuar nga Udhëheqësi i Departamentit dhe janë miratuar nga Kryeshefi Ekzekutiv. Gjithsej janë nxjerrë nëntë (9) Programe të punës inspektuese, prej të cilave, katër (4) për inspektime të rregullta dhe pesë (5) për inspektime të jashtëzakonshme. Programet kanë përmbajtur: arsyet e inicimit, objektin, subjektin, shtrirjen, objektivat, rëndësinë, periudhën e mbulimit - realizimit, kriteret e vlerësimit, drejtimet, përgjegjësitë e ekipit inspektues, kushtet e raportimit etj.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE PËR INSPEKTIMET E REALIZUARA

Inspektimi nr. 01/2021:

Trajtimi i personave të ndaluar përkohësisht në Stacionin Policor në Ferizaj

Arsyet e inicimit:

Më 12 shkurt 2021, Kryeshefi Ekzekutiv ka kërkuar inicimin e një inspektimi të jashtëzakonshëm për të vlerësuar respektimin e të drejtave të personave të ndaluar përkohësisht në Stacionin Policor të Ferizajt. Ky inicim ka ardhur me kërkesë të Udhëheqësit të Departamentit të Hetimeve të IPK-së, të datës 11 shkurt 2021, në mënyrë që të vlerësohet ligjshmëria e mbajtjes së personave të ndaluar përkohësisht në këtë stacion, me theks të veçantë në “dhomat e ndalimit”.

Objektivat dhe metodologjia

Objektivi i këtij inspektimi ka qenë që të vlerësohet respektimi i rregullave e procedurave policore në trajtimin e personave të ndaluar përkohësisht. Ky inspektim është përqendruar në Stacionin Policor - Ferizaj. Gjatë inspektimit janë zhvilluar katër (4) takime-intervista me punonjës përgjegjës të strukturës policore. Janë kryer këqyrje - kontrole të kushteve fizike, higjienike dhe të sigurisë brenda hapësirave në stacion policor (dedikuar për trajtimin e personave të ndaluar përkohësisht), si dhe regjistrave e dokumenteve që lidhen me ndalimin e përkohshëm.

Gjetjet kryesore:

Inspektimi i realizuar vë në pah nevojën e hartimit të PSO-së mbi trajtimin e personave të ndaluar përkohësisht dhe kushtet nën të cilat duhet mbajtur ata. Nevojitet përgatitja e procesverbaleve të veçanta mbi ndalimin e përkohshëm policor deri në gjashtë orë. Po ashtu ka nevojë të ndërmerren veprime të menjëhershme në aplikimin e praktikave të mbajtjes së evidencave lidhur me ndalimin e këtyre personave. Inspektimi rekomandon ndërmarrjen e veprimeve për të ndaluar praktikën e mbajtjes së personave përkohësisht të ndaluar nën kushtet aktuale.

Rekomandimet:

Në këtë inspektim janë dhënë gjithsej katër (4) rekomandime, të cilat i atribuohen gjetjeve. Me strukturën policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 02/202

Vlerësimi i performancës së stacioneve policore në Obiliq, Podujevë dhe Skënderaj

Arsyet e inicimit:

Më 30 mars 2021, Kryeshefi Ekzekutiv ka kërkuar inicimin e inspektimit të jashtëzakonshëm për të vlerësuar aktivitetet operative, funksionimin dhe menaxhimin e stacioneve policore në Obiliq, Podujevë dhe Skënderaj. Ky inicim ka ardhur me kërkesë të Ministrit të Punëve të Brendshme. Inspektimi i kësaj fushe të menaxhimit paraqet fushë me interes për IPK-në me qëllim të vlerësimit nëse Policia ka kapacitete të mjaftueshme teknike dhe njerëzore për të kryer detyrat në raport me përgjegjësitë.

Objektivat dhe metodologjia:

Objektivat e këtij inspektimi kanë qenë: të vlerësohet organizimi, funksionimi dhe kapacitetet e burimeve njerëzore, të vlerësohen aktivitetet operative (patrulluese dhe hetimore) të stacioneve, të vlerësohen shërbimet logjistike dhe kushtet e sigurisë në kuadër të stacioneve. Gjatë inspektimit: janë zhvilluar takime - intervista me tre (3) punonjës përgjegjës të strukturës së stacioneve; janë kryer këqyrje-verifikime të kushteve të sigurisë në stacione policore, automjeteve dhe pajisjeve të zyrtarëve policor, regjistrave dhe dokumenteve që lidhen me aktivitetet. Janë siguruar dhe marrë dëshmi, si plane, raporte, procesverbale dhe dëshmi tjera.

Gjetjet kryesore:

Inspektimi i realizuar vë në pah nevojën e stabilizimit të strukturës së stacioneve policore me burime të nevojshme njerëzore dhe eliminimin e dobësive lidhur me sistemimin. Shtrohet nevoja e konsolidimit të evidencave mbi vijueshmërinë në punë (Podujevë). Duhet bërë përpjekje për të eliminuar vonesat për regjistrim me kohë të rasteve në SIPK (Skënderaj). Janë identifikuar situata kur rastet janë proceduar pa u nënshkruar nga autoriteti kompetent (Podujevë). Është kërkuar nga stacionet policore që të shtojnë përpjekjet për sigurimin e informatave më të shumta inteligjente. Janë hasur pajisje për fikjen e zjarrit me afat të skaduar. Te patrullat e stacioneve është hasur mungesë e konsideruar e pajisjeve për punë.

Rekomandimet:

Lidhur me inspektimin janë dhënë tetë (8) rekomandime që i atribuohen gjetjeve. Me strukturën përkatëse policore është arritur pajtim për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 03/2021:

Monitorimi i besueshmërisë dhe kënaqshmërisë së publikut me Policinë e Kosovës

Arsyet e inicimit:

Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta i Departamentit të Inspektimit të IPK-së për vitin 2021 ka përfshirë kryerjen e inspektimit për monitorimin e besueshmërisë e kënaqshmërisë së publikut me Policinë. Policia ka vlerësuar kyç rolin e IPK-së për të realizuar një hulumtim të pavarur në matjen e perceptimit publik për punën policore. Duke konsideruar se inspektimi është instrument i suksesshëm për të vlerësuar trajtimin e kësaj fushe, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së më 1 shkurt 2021 ka iniciuar inspektim për të marrë opinionet e publikut mbi performancën policore.

Objektivat dhe metodologjia:

Objektivat e inspektimit kanë qenë: matja e vlerësimi i nivelit të besueshmërisë e kënaqshmërisë së publikut me Policinë; identifikimi i fushave ku Policia duhet të përmirësojë performancën e saj në drejtim të ofrimit të shërbimeve më të mira për publikun; dhe identifikimi i faktorëve që kanë ndikuar në nivelin aktual të besueshmërisë dhe kënaqshmërisë, të dala nga rezultatet e anketës.

Hulumtimi përmes anketës ka pasur në fokus perceptimin e qytetarëve në mënyrë rastësore sipas mostrës së paracaktuar. Hulumtimi është realizuar duke u shërbyer me Pyetësin, përmes të cilit janë mbledhur të dhëna sistematike mbi fushat me interes. Hulumtimi është realizuar në të gjitha komunat dhe mostra e paracaktuar ka përfshirë 0.1% të qytetarëve (1.782 të anketuar). Të dhënat e mbledhur janë administruar në SPSS¹³, duke gjeneruar analizat e nevojshme. Shkalla e përgjigjeve të të anketuarve ka qenë 100%. Prej 1.782 të anketuarve, 49% kanë qenë meshkuj kundrejt 51% femra. Mostrimi ka marrë parasysh dhe shtresimin sipas vendbanimeve urbane - rurale në raportin 38%:62%. IPK-ja ka përfshirë në hulumtim qytetarë të angazhuar në sektorin publik, privat dhe që nuk janë pjesë e ndonjë aktiviteti ekonomik. Rreth 20.7% e të anketuarve i kanë takuar sektorit publik, 54.4% sektorit privat dhe 24.9% nuk janë të punësuar ose janë student dhe të pensionuar. Mosha mesatare e pjesëmarrësve të anketuar është 34.8 vjet. Hulumtimi ka marrë parasysh shpërndarjen e mostrës dhe sipas përkatësisë etnike, ku të anketuarit e shumicës shqiptare janë përfaqësuar me 91%, derisa ata nga pakicat me 9%.

Gjetjet kryesore:

Nga rezultatet e anketimit del në pah nevoja për një angazhim më të ngushtë të policëve sektorial me komunitetin. Ka një perceptim jo të kënaqshëm mbi qasjen dhe përdorimin e forcës në raport me qytetarët. Mbi gjysma e të anketuarve mendon se Policia i trajton të gjithë njësoj pa marrë parasysh diversitetin gjinor, etnik, religjioz, etj. Pjesa më e madhe e të anketuarve mendojnë se punohet pak në parandalimin e veprave kriminale. Vjedhjet konsiderohen shqetësimi kryesor i sigorisë në komunitetet e të anketuarve, pasuar nga drogat, siguria në rrugë, prishja e rendit dhe qetësisë publike, etj. Metoda më e preferuar që mund t'i kontribuojë ngritjes së nivelit të sigorisë në komunitet konsiderohet patrullimi më i shpeshtë. Të anketuarit në përqindje më të lartë i besojnë Policisë, pasuar nga Forca e Sigurisë së Kosovës, Gjykata dhe Prokuroria e Shtetit. Është inkurajuese gatishmëria e të anketuarve për të raportuar krimin nëse do të ishte i pranishëm në shoqëri. Afërsisht gjysma e të anketuarve janë të kënaqur me trajtimin që iu është bërë rasteve të tyre kur kanë qenë palë në Polici. Hulumtimi ka nxjerrë një opinion jo të pritshëm sa i përket perceptimit mbi praninë e korrupsionit brenda Policisë, ngase afërsisht gjysma e të anketuarve mendon se ka korrupsion në Polici. Sektori policor, i cili perceptohet të jetë më i ekspozuar ndaj korrupsionit është kufiri dhe trafiku, pasuar nga hetimet dhe administrata.

¹³ SPSS është shkurtës për Paketën Statistikore për Shkencat Shoqërore (Statistical Package for the Social Science). Konsiderohet si një nga paketat statistikore më të popullarizuara, përmes të cilës mund të manipulohet të dhëna të ndryshme dhe analizohet duke ndjekur instruksione mjaft të thjeshta.

Inspektimi nr. 04/2021:

Menaxhimi, funksionimi dhe aktivitetet hetimore të Drejtorisë së Hetimit të Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit

Arsyet e inicimit:

Më 31 mars 2021, Kryeshefi Ekzekutiv ka kërkuar inicimin e inspektimit të jashtëzakonshëm për të vlerësuar aktivitetet hetimore, funksionimin e menaxhimit dhe DHKEK-së. Ky inicim ka ardhur me kërkesë të Ministrit të Punëve të Brendshme, të datës 30 mars 2021. Inspektimi i kësaj fushe të menaxhimit paraqet fushë me interes për IPK-në me qëllim që të vlerësohet nëse DHKEK ka strukturë funksionale me kapacitete të mjaftueshme teknike e njerëzore për hetimin dhe zbulimin e krimit, ka nxjerrë dhe zbatuar bazën ligjore dhe strategjike të nevojshme për të ulur trendet e krimit, si dhe është përfshirë seriozisht me përkushtim në përmbushjen e objektivave në forcimin e sundimit të rendit dhe ligjit në vend.

Objektivat dhe metodologjia:

Objektivat e inspektimit kanë qenë: të vlerësohet organizimi, funksionimi dhe kapacitetet; të vlerësohet performanca e DHKEK-së në hetimin dhe zbulimin e krimeve, dhe të vlerësohet administrimi i dosjeve (ruajtja dhe arkivimi).

Gjatë inspektimit: janë zhvilluar dy (2) takime - intervista me bartës funksionesh dhe përgjegjës të strukturës hetimore, janë kryer këqyrje - verifikime të kushteve të punës, të administrimit të dosjeve penale, të kushteve teknike e sigurisë në arkiv, si dhe librave të evidencave dhe dosjeve, janë siguruar dhe marrë kopje të raporteve vjetore të punës, baza ligjore që rregullon aktivitetet dhe detyrat në këtë Drejtori, kopje të gjashtë (6) dosjeve penale për lëndët e proceduara me kallëzim penal dhe me raporte të veçanta.

Gjetjet kryesore:

Inspektimi vë në pah nevojën për t'u siguruar DHKEK se është ndarë qartë kompetenca lëndore e njësive rajonale në raport me sektorët qendror të DHKEK. Shihet e nevojshme që të rishikohen politikat aktuale të trajtimit të informatave, duke synuar ndryshimin - plotësimin e PSO-së, drejt rregullimit të procedurës mbi pranimin e palëve, regjistrimin paraprak dhe mbajtjen e shënimeve zyrtare mbi rastet e raportuara. Ka shmangie nga respektimi i dispozitës për dorëzimin e raportit njoftues për prokurorin mbi dyshimin e arsyeshëm të veprës penale. Ka lëshime edhe sa i përket nënshkrimit nga palët, të procesverbaleve të marrjes në pyetje. Është identifikuar edhe mungesë e planeve të hetimeve lidhur me rastet.

Rekomandimet:

Në këtë inspektim janë dhënë gjashtë (6) rekomandime, që i atribuohen gjetjeve. Me strukturën përkatëse policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 05/2021:

Kryerja e detyrave gjatë trajtimit policor të dhunës në familje

Arsyet e inicimit:

Meqenëse dhuna në familje paraqitet si shqetësim gjithnjë në rritje dhe sfidues për institucionet shtetërore, është e nevojshme që të trajtohet si dukuri evidente. Pas rastit të vrasjes së një gruaje (M.O) në qytetin e Ferizajt, Ministri i Punëve të Brendshme, ka kërkuar realizimin e një inspektimi të jashtëzakonshëm, për të vlerësuar performancën në trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Lidhur me këtë, Kryeshefi Ekzekutiv, më 26 gusht 2021 ka autorizuar inicimin e inspektimit të jashtëzakonshëm për të vlerësuar kryerjen e detyrave policore në këtë fushë të hetimit.

Objektivat dhe metodologjia:

Objektivat e inspektimit kanë qenë: vlerësimi i bazës ligjore dhe kapacitetet për hetimin e dhunës në familje; analizimi e vlerësimi i indikatorëve që lidhen me rastet e dhunës në familje, vlerësimi i performancës për hetimin e rasteve të dhunës në familje, vlerësimi i respektimit të procedurave gjatë hetimit të rasteve të dhunës në familje. Inspektimi është përqendruar në drejtoritë rajonale policore, konkretisht në sektorët rajonal të hetimeve. Gjatë inspektimit: janë zhvilluar takime - intervista me 19 drejtues, punonjës e bartës funksionesh brenda strukturës hetimore të drejtorive rajonale, stacioneve dhe DPBP-së; janë kryer inspektime - kontrolle fizike të dosjeve të rasteve të hetimit të dhunës në familje; janë marrë dëshmi mbi kapacitetet, raporte të punës së njësive hetimore dhe kopjet e dosjeve të rasteve (146 sosh).

Gjetjet kryesore:

Inspektimi vë në pah nevojën që të shtyhet para procesi i finalizimit për ndryshimin e PSO - Hetimi i Dhunës Familjare, më qëllim harmonizimi të plotë me Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Në të ardhmen duhet funksionalizuar ambientet e veçanta si “dhoma mike”, si praktika të aplikuar në vendet e zhvilluara, për trajtimin e viktimave të dhunës në familje. Ka nevojë që brenda programeve trajnuese nga fusha e dhunës familjare, të përfshihet edhe personeli policor i njësive patrulluese, me synimin që njësitë e tilla të kenë njohuritë e duhura për të reaguar në raste. Mbrojtësit e Viktimave nuk po ftohen në të gjitha rastet e raportuara të dhunës në familje, duke mos qenë në funksion të viktimave. Përdorimi i formave bazike të vlerësimit të riskut nuk po ndodhë sa duhet në rastet e dhunës në familje. Viktimat nuk po pajisen sa duhet me pakot informuese të viktimave, për t’u njoftuar në vazhdimësi për hetimin e rasteve. Rekomandohet që në të gjitha rastet e dhunës në familje kur dëshmohej se ndaj viktimave është ushtruar dhunë fizike, të sigurohen fotografi mbi lëndimet dhe të krijohen fotoalbumet në drejtim të pasurimit të dosjeve, drejt dëshmimit të dhunës së përdorur. Nuk po ndodhë sa duhet testimi i përdorimit të alkoolit tek të dyshimtit. Nxitet Policia që në të gjitha rastet kur ka dhunë, të përpilohet raport lidhur me rastin, pavarësisht a është kryer vepra apo jo, dhe një kopje të këtij raporti t’i dërgohet Koordinatorit për dhunën në familje në nivel qendror. Duhet gjetur alternativa për angazhim të njësive policore për mbikëqyrje të vazhueshme të zbatimit të urdhrave mbrojtës të viktimave. Duhet punuar në konsolidimin e evidencave mbi rastet e dhunës në familje.

Rekomandimet:

Në këtë inspektim janë dhënë 11 rekomandime, që i atribuohen gjetjeve. Me strukturën policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 06/2021:

Menaxhimi i prokurimit dhe kontratave me operatorët ekonomik

Arsyet e inicimit:

Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta në vitin 2021 ka paraparë kryerjen e inspektimit në fushën e menaxhimit të prokurimit dhe të kontratave me operatorët ekonomik. Inspektimi i kësaj fushe paraqet interes për IPK, me qëllim që të vlerësohet nëse Policia është e orientuar në shfrytëzimin racional e të drejtë të fondeve që i besohen. Kryeshefi Ekzekutiv më 20 maj 2021 ka iniciuar një inspektim për vlerësuar performancën policore në këtë fushë të menaxhimit. Inicimi i inspektimit është ndikuar dhe nga nevoja që Policia të sigurohet se taksat e qytetarëve janë duke u shfrytëzuar në mënyrë efektive dhe efikase në funksion të përmbushjes së misionit.

Objektivat dhe metodologjia:

Objektivat kryesore të inspektimit kanë qenë: të vlerësohet respektimi i dispozitave, rregullave e procedurave të prokurimit publik, të vlerësohet përmbushja e kushteve të kontratave nga OE-të dhe organizata, të vlerësohet përmbushja e detyrave nga menaxherët e projekteve dhe komisionet përkatëse në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve, të vlerësohet përmbushja e rekomandimeve të kaluara. Inspektimi është përqendruar në Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse.

Gjatë inspektimit: janë zhvilluar takime - intervista me 11 drejtues, punonjës e bartës funksionesh; janë kryer inspektime - kontrolle fizike të cilësisë së punimeve të realizuar në projekte kapitale, janë marrë dokumente të shkruara, planet e prokurimit, raportet vjetore, dosjet e aktiviteteve të prokurimit të blerjeve/shërbimeve/ punëve (15 dosje për vitet 2019/2020), dosjet e menaxhimit të kontratave, si dhe dosjet e pagesave.

Gjetjet kryesore:

IPK nxitë një bashkëpunim dhe koordinim në kuadër të drejtorive që gjatë fazave para nxjerrjes së planeve të prokurimit. Inkurajohet DMO që të përgatis projekte cilësore, me fokus të veçantë me parametra të qartë dhe të saktë teknik. Duhet t'i iket konfliktit të interesit sa i përket përbërjes së komisioneve të ekzaminimit, vlerësimit e krahasimit të tenderëve. Janë identifikuar stërzgjatje të proceseve të vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve. Duhet eliminuar rastet e mos trajtimit të duhur të tenderëve me çmime jo normalisht të ulët. Të sigurohet AK-ja që kontratat me OE-të po arrihen me çmime tregu, pa dëmtuar buxhetin. Nxitet një mbikëqyrje më efikase në menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit, duke i kushtuar rëndësi mbarëvajtjes së proceseve të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Është e nevojshme të analizohen dhe vlerësohen ecuritë e realizimit të projekteve kapitale, duke synuar identifikimin e dobësive të mundshme teknike, financiare ose profesionale, në drejtim të ngritjes së efektivitetit dhe shkurtimit të periudhës së realizimit të projekteve lidhur me kontratat për punë. Inkurajohet DMO që të ushtrojë kontroll të shtuar mbi menaxherët e projekteve, në mënyrë që të respektohen në përpikëri kushtet e kontratave dhe në drejtim të sigurimit të cilësisë së punimeve, të merret parasysh periudha e eliminimit të të metave, në mënyrë që vetëm pasi të ketë përfunduar periudha e tillë, më pas të lëshohen certifikatat përfundimtare të inspektimit.

Rekomandimet: Në këtë inspektim janë dhënë 15 rekomandime, që i atribuohen gjetjeve. Me strukturën përkatëse policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 07/2021:

Menaxhimi i patrullimeve dhe sigurisë në rrugë

Arsyet e inicimit:

Plani Vjetor ka paraparë kryerjen e inspektimit mbi menaxhimin të patrullimeve dhe sigurisë në rrugë. Inspektimi i kësaj fushe paraqet interes për IPK-në, me qëllim që të vlerësohet nëse Policia ka ndërtuar kapacitete të nevojshme ligjore, njerëzore e teknike për të kryer detyrat e përgjegjësitë e përcaktuara me ligj. Përmes këtij inspektimi është synuar të verifikohet gjendja dhe kryerja e detyrave në menaxhimin e sigurisë rrugore. Duke konsideruar se inspektimi paraqet instrument shumë të suksesshëm për të vlerësuar trajtimin e kësaj fushe të menaxhimit, Kryeshefi Ekzekutiv më 3 qershor 2021 ka inicuar këtë inspektim për të vlerësuar performancën policore në këtë fushë menaxhimi. Inicimi është ndikuar dhe nga nevoja që Policia të sigurohet se ka ndërmarr veprimet e duhura në ruajtjen e jetëve të qytetarëve, duke ngritur nivelin e sigurisë rrugore.

Objektivat dhe metodologjia:

Objektivat e inspektimit kanë qenë: të vlerësohen kapacitetet operationale të njësive të trafikut; të vlerësohen masat parandaluese në ngritjen e sigurisë rrugore, të matet e vlerësohet efikasiteti dhe performanca në trajtimin e aksidenteve, të analizohen dhe vlerësohen indikatorët e sigurisë rrugore, të vlerësohet niveli i pajimit të njësive patrulluese me pajisjet e nevojshme të punës, të vlerësohet përmbushja e rekomandimeve të kaluara. Inspektimi është përqendruar në DKR, NJKA dhe NRKRR.

Gjatë inspektimit: janë zhvilluar takime - intervista me 10 drejtues, punonjës e bartës funksionesh brenda DKR-së dhe njësive të trafikut; janë kryer inspektime - kontrole fizike të evidencave dhe procedimit të informatave në SIPK, patrullave policore mbi metodat e aplikuara të ndaljes së mjeteve, pajisjeve dhe mjeteve të punës, kushteve të punës); janë marrë dokumente të shkruara, raporte vjetore të njësive, analiza mbi gjendjen e sigurisë rrugore, planet strategjike - operative, raporte pas-operationale, raportet e ndërrimeve, oraret e ekipeve, fletë patrullat, kopjet e dosjeve të aksidenteve (180 dosje).

Gjetjet kryesore:

IPK nxitë organizimin e trajnimit mbi analizat e aksidenteve, në mënyrë që të avancohet edhe më shumë hetimi në rasteve. Duhet të shtohet kontrolli mbi ekipet e zyrtarët patrullues në zbatimin e lëshimit të vërtetimit për rastet kur ndaj pjesëmarrësve në trafik realizohet matja e prezencës së alkoolit. Janë evidentuar mungesa të pajisjeve të matjes së shpejtësisë së lëvizjes së mjeteve. Duhet angazhuar që të zbatohen në përpikëri rregullat mbi konfiskimin e patentë shoferëve. Janë hasur vonesa në zbatimin e afateve kohore për futjen e të dhënave në SIPK. Duhet shqyrtuar mundësitë teknike dhe buxhetore për të funksionalizuar aplikacionin e integruar në makina, që ndërlihet me të dhënat e SIPK-ut, në mënyrë që njësitë e trafikut të mund të kryejnë verifikimet e nevojshme nga vendi i ngjarjes. Rezultatet e inspektimit tregojnë se nuk po lëshohen vërtetime me rastin e

leximit të tahogرافit, me të cilin dëshmohej se është kontrolluar dhe lexuar. Në shumë raste nuk po raportohet koha e arritjes së patrullave në vendndodhje të aksidenteve. Me rastin e trajtimit të aksidenteve duhet shtuar numri i deklaratave, duke i përfshirë edhe ato të pjesëmarrësve tjerë në aksidente dhe dëshmitarëve. IPK-ja inkurajon zyrtarët e njësive të trafikut që të përdorin pajisjet për matjen e pranisë së alkoolit në rastet e aksidenteve, kurse mbikëqyrësve iu rekomandon aplikimin e kontrolleve të dosjeve mbi përdorimin e alkootesteve. Ka nevojë që të ngritet cilësia e kallëzimeve penale nga aspekti përmbajtësor dhe drejtshkrimor. IPK këshillon policët që gjatë aktivitetit patrullues për ndaljen dhe kontrollin e dokumenteve dhe automjeteve, të respektojnë procedurat dhe të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme të sigurisë, në drejtim të ngritjes së profesionalizmit, integritetit policor dhe krijimit të një imazhi të mirë para kundërvajtësve dhe qytetarëve. Patrullat me rastin e daljes në terren duhet të pajisen me të gjitha pajisjet, mjetet e punës dhe dokumentet e domosdoshme për nevoja të rregullimit të trafikut.

Rekomandimet:

Lidhur me këtë inspektim janë dhënë 16 rekomandime, që i atribuohen gjetjeve. Me strukturën përkatëse policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 08/2021:

Performanca policore në realizimin e urdhëresave të gjykatave

Arsyet e inicimit:

Kjo fushë është identifikuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së, si një fushë që shtron nevojën për trajtim të vazhdueshëm e që është e ndjeshme. Është kjo fusha e zbatimit të urdhëresave të gjykatave, me administrimin e të cilave merren stacionet. Inspektimi i kësaj fushe paraqet interes për IPK-në me qëllim që të vlerësohet nëse Policia është e angazhuar sa duhet në ekzekutimin e urdhëresave. Kjo fushë nuk është trajtuar sa duhet në të kaluarën e inspektimi paraqet mundësi për të vlerësuar mënyrën se si administrohen urdhëresat, cilat janë kapacitetet e angazhuara në realizimin e tyre, sa janë efektive strukturat e stacioneve policore në zbatimin e tyre dhe sa mirëmbahen evidencat. Më 12 nëntor 2021, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së ka autorizuar inspektim të jashtëzakonshëm, për të vlerësuar performancën policore në zbatimin e urdhëresave. Inicimi i inspektimit është ndikuar dhe nga nevoja që Policia të sigurohet që sigurisë publike po i jepet prioritet i duhur, drejt ofrimit të një mjedisi më të sigurtë për qytetarët.

Objektivat dhe metodologjia:

Objektivat kryesore të inspektimit kanë qenë: të identifikohen e vlerësohen procedurat e veprimit, si dhe kapacitetet e burimeve njerëzore të angazhuara në zbatimin e urdhëresave, të matet dhe vlerësohet performanca, si dhe efikasiteti i stacioneve në zbatimin e urdhëresave, të vlerësohet mbajtja e evidencave mbi pranimin/regjistrimin/ekzekutimin dhe shlyerjen e urdhëresave të gjykatave. Inspektimi është përqendruar në zyrat e evidentimit dhe ekzekutimit të urdhëresave në kuadër të stacioneve, Zyrën e Sistemit të Menaxhimit Kufitar dhe Zyrën Qendrore të SIPK-ut.

Gjatë inspektimit: janë zhvilluar takime - intervista me 50 drejtues, punonjës e bartës funksionesh, përfshirë: administratorë të urdhëresave dhe zyrtarë të SIPK-ut, janë kryer inspektime - kontrole fizike të 171 dosjeve të urdhëresave të gjykatave për vitet 2019 e 2020 (të parashkruara/skaduara) dhe regjistrave (evidencave), janë marrë dokumente të shkruara, dëshmi mbi kapacitetet, raportet periodike të punës dhe kopjet e dosjeve të urdhëresave (171 sosh).

Gjetjet kryesore:

IPK-ja nxitë Departamentin për Operacione dhe Zyrën Ligjore të Policisë të shqyrtojë mundësinë e rishikimit të PSO - Ekzekutimi i Urdhëresave të Gjykatave, duke synuar ndarjen e qartë të detyrave të personelit të ngarkuar në administrimin dhe ekzekutimin e tyre, varësisht organizimit brenda stacioneve. Nevojitet zbatimi i një sërë masash që do të ngriste cilësinë e raportimit dhe mbajtjes së evidencave, duke marrë parasysh stabilizimin e vendeve të punës në administrimin e urdhëresave, organizimin e trajnimit të personelit, nxjerrjen e Udhëzuesit për administrim të urdhëresave, rishikimin e statusit të urdhëresave dhe përpunimin e të dhënave. Duhet marrë parasysh mundësia e standardizimit të mënyrës së pranimi të urdhëresave (përmes regjioneve

apo stacioneve), duke përzgjedhur njërin prej mënyrave më efikase, që ofron mundësi për reagim më të shpejt dhe që shkurton kohën që ato të arrijnë tek njësitë që do të merren me ekzekutimin. Duhet të shtohet kontrolli për futje të urdhëresave në SIPK dhe regjistrimi i tyre të bëhet me kohë. Duhet të shtohet intensiteti i angazhimeve në ekzekutimin e urdhëresave, në mënyrë që aktivitetet të jenë më të shumta në kapjen e të dyshuarve dhe të dënuarve, drejt krijimit të një ambienti më të sigurt dhe ngritjes së bashkëpunimit me gjykatat. Duhet pasur edhe më shumë angazhime në mënyrë që përditësimi i të dhënave mbi urdhëresat e skaduara, të ndodhë me kohë. Në këtë drejtim, administratorët e urdhëresave duhet të ngrisin bashkëpunimin me gjykatat lidhur me statusin e lëndëve, drejt përditësimit të rregullt të rasteve.

Rekomandimet:

Në këtë inspektim janë dhënë shtatë (7) rekomandime, që i atribuohen gjetjeve. Me strukturën përkatëse policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

Inspektimi nr. 09/2021:

Menaxhimi i hetimit dhe zbulimit të krimit

Arsyet e inicimit:

Plani Vjetor i Inspektimeve ka paraparë kryerjen edhe të inspektimit mbi menaxhimin e hetimit dhe zbulimit të krimit. Ky inspektim paraqet interes për IPK-në, me qëllim që të vlerësohet nëse stacionet kanë strukturë funksionale, kapacitete njerëzore/ teknike e profesionale, për të adresuar shqetësimet e komunitetit lidhur me krimin në shoqëri dhe dukuritë tjera negative. Është synuar të vlerësohen angazhimet policore në ngritjen e shkallës së zbulueshmërisë së krimeve. Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së më 28 maj 2021 ka iniciuar inspektim për vlerësuar performancën e stacioneve policore të kategorisë A, në këtë fushë menaxhimi. Inicimi i inspektimit është ndikuar edhe nga nevoja që të vlerësohet përkushtimi e serioziteti i njësive hetimore në reduktimin e kriminalitetit, në drejtim të forcimit të sundimit të rendit e ligjit.

Objektivat dhe metodologjia:

Objektivat kryesore të inspektimit kanë qenë: të vlerësohen kapacitetet në fushën e hetimit të krimit, të vlerësohet respektimi i rregullave e procedurave në hetimin dhe zbulimin e krimit, të vlerësohet dokumentimi i vendngjarjes dhe trajtimi i dëshmive që lidhen me krimin, të vlerësohet respektimi i të drejtave të viktimave e të dyshuarve në procedurë, të analizohen dhe vlerësohen indikatorët e performances në luftimin e krimit. Inspektimi është përqendruar në gjithë stacionet policore të kategorisë A.

Gjatë inspektimit janë zhvilluar takime - intervista me 13 drejtues, punonjës e bartës funksionesh në kuadër të sektorëve hetimor në stacione, janë kryer inspektime - kontrole fizike të dosjeve hetimore, dëshmive mbi mënyrën e trajtimit (130 sosh), kushteve fizike e sigurisë së dhomave të dëshmive dhe evidencave fizike dhe elektronike të dëshmive, janë marrë dokumente të shkruara, raporte vjetore të sektorëve hetimor, kopjet e dosjeve penale (130), kopjet e zinxhirëve të ruajtjes e evidencave të dëshmive, raportet e revizionit/inventarizimit dhe inspektimit, etj.

Gjetjet kryesore:

Inspektimi pasqyron nevojën që në kurset bazike të hetimit të krimit, si dhe trajtimit të dëshmive, të ketë përfshirje më të madhe të hetuesve nga sektorët hetimor të stacioneve policore. Shtrohet nevoja për një rishikim të numrit të hetuesve nëpër sektorët e hetimeve të stacioneve për shkak të numrit të madh të rasteve, duke synuar një shpërndarje më adekuate burimesh. Duhet ngritur serioziteti në punën e zyrtarëve që regjistrojnë të dhëna në SIPK, që të sigurohen se regjistrohen saktë duke u mbështetur në dokumente identifikimi. Ka ngecje në përmbushjen e obligimeve që dalin nga neni 70, paragrafi 5 i KPP-së, sipas së cilës dispozitë, Policia posa të ketë dyshim të arsyeshëm se është kryer vepër penale, brenda 24 orësh t'i dërgoj raport Prokurorit kompetent të Shtetit, i cili më pas vendosë nëse duhet filluar procedura penale. IPK-ja u rekomandon zyrtarëve policor të sektorëve të hetimeve të stacioneve policore, që me rastin e marrjes në pyetje, dëshmitarëve apo të dyshuarve t'iu lexohen paralajmërimet mbi të drejtat e tyre, konform dispozitave ligjore të KPP-së, dhe në fund të marrjes në pyetje, procesverbalet të mos procedohen pa nënshkrimin e palëve. Dosjet para dorëzimit në Prokuroritë kompetente duhet t'i nënshtrohen kontrollit më të rreptë dhe më pas të nënshkruhen nga personat kompetent. Edhe gjatë këtij inspektimi janë hasur disa dobësi që duhet eliminuar mbi sistemimin e dëshmive, akomodimin, regjistrimin, kushtet dhe kontrollet e brendshme në dhomat e dëshmive.

Rekomandimet: Në këtë inspektim janë dhënë 13 rekomandime, që i atribuohen gjetjeve. Me strukturën përkatëse policore është arritur pajtueshmëri për përmbushjen e tyre sipas Planit të Veprimit.

8. PLANIFIKIMI STRATEGJIK, ÇËSHTJET LIGJORE, MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN, PROMOVIMI DHE BASHKËPUNIMI

Departamenti për Planifikim, Bashkëpunim, Çështje Ligjore dhe Informim është një ndarje organizative në kuadër të strukturës së organizimit të IPK-së dhe si i tillë funksionon nga viti 2017.

Përgjegjësitë (detyrat) e këtij Departamenti janë:

- udhëheqë aktivitetet në nxjerrjen e planeve strategjike, bazuar në objektivat strategjike të Ministrisë, si dhe vlerëson zbatimin e planeve për përmbushjen e objektivave strategjike;
- siguron shërbime juridike/këshilluese ligjore për të siguruar menaxhim efektiv të rreziqeve ligjore dhe kontraktuale;
- udhëheqë aktivitetet për nxjerrjen, rishikimin-plotësimin e udhëzimeve, rregulloreve dhe PSO-ve lidhur me funksionet e IPK-së;
- udhëheqë me aktivitetet në zhvillimin dhe avancimin e bashkëpunimit e partneritetit ndër institucional brenda dhe jashtë vendit;
- udhëheqë aktivitetet e organizatës në ofrimin e shërbimeve profesionale në fushën e komunikimit dhe informimit publik;
- udhëheqë me aktivitetet për të siguruar realizimin e politikave në promovimin e vlerave, me qëllim të ngritjes së besimit dhe fuqizimit të rolit mbikëqyrës të IPK-së.

DPBÇLI zhvillon aktivitetin në dy (2) divizione:

- Divizionin për Planifikim dhe Çështje Ligjore;
- Divizionin për Bashkëpunim dhe Informim.

Departamenti ka të punësuar gjashtë (6) punonjës.

DEPARTAMENTI PËR
PLANIFIKIM,
BASHKËPUNIM,
ÇËSHTJE LIGJORE DHE
INFORMIM

Ne u angazhuam në sensibilizimin e qytetarëve për të shprehur përkushimin tonë për trajtimin e shqetësimeve të tyre:

o Publikuam mbi 60 komunikata,

o Ofruam informacione për medie në mbi 200 kërkesa të tyre;

o Realizuam takime me qytetarë, forume të sigurisë, OJQ, institucione, etj;

o Hartuam dokumente planifikuese dhe akte nënligjore;

IPK-ja gjatë vitit 2020 është angazhuar në përmbushjen e detyrave që kanë dalë nga Plani Zhvillimor Strategjik 2019 - 2021 dhe detyra të tjera sipas nevojave. Aktivitetet në fushën e marrëdhënieve me publikun, bashkëpunimit vendor e ndërkombëtar, planifikimit strategjik dhe çështjeve ligjore, IPK i ka realizuar përmes Departamentit për Planifikim, Bashkëpunim, Çështje Ligjore dhe Informim.

DPBÇLI është angazhuar në aspektin e planifikimit strategjik duke përgatitur Planin Vjetor dhe Planin e Veprimit, pastaj përgatitjen dhe azhurnimin e Listës së Analizës së Riskut për IPK-në, finalizimin e Procedurave Standarde të Operimit etj. Angazhimet e DPBÇLI-së janë fokusuar edhe në fuqizimin e bashkëpunimit me qytetarë, institucione vendore dhe ndërkombëtare.

a) Bashkëpunimi me institucionet vendore

Në kuadër të bashkëpunimit vendor, DPBÇLI kanë pasur aktivitete me rëndësi në fuqizimin e këtij bashkëpunimi. Si pikë e kontaktit me institucionet vendore, janë trajtuar të gjitha kërkesat që kanë ardhur në adresën e IPK-së. Në bashkëpunim me departamentet e tjera, janë kthyer përgjigjet në MPB mbi raportimet për përmbushjen e objektivave strategjike të Planit të MPB-së dhe Qeverisë. DPBÇLI ka trajtuar të gjitha kërkesat për qasje në dokumente publike, si dhe ka raportuar te Zyra e Kryeministrit mbi numrin e kërkesave të trajtuara.



Në kuadër të angazhimeve me institucionet e tjera, është ngritur niveli i bashkëpunimit me Avokatin e Popullit për fushën e të drejtave e lirive të njeriut. DPBÇLI ka trajtuar kërkesat që kanë ardhur nga ky institucion, respektivisht nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës. Janë trajtuar kërkesat e ardhura nga Avokati i Popullit, përfshirë edhe kërkesat për hapjen e rasteve sipas detyrës zyrtare.

Gjatë punës së përditshme, punonjësit e strukturës hetimore dhe menaxhmenti kanë fuqizuar bashkëpunimin me Prokurorin e Shtetit në drejtim të luftimit të korrupsionit dhe veprave tjera të penale. Kjo

ka ndikuar që IPK dhe Prokuroria e Shtetit zhvillojnë raporte të bashkëpunimit në luftimin e dukurive negative, të cilat hasen Polici, e në veçanti në luftimin e korrupsionit, përmes shkëmbimit të informatave dhe trajtimit të tyre mbi dyshimin e implikimit në veprimtari penale të zyrtarëve policor.

Bashkëpunimi me Policinë është i orientuar në dhënien e kontributit për ngritjen e performancës së dy agjencive dhe ofrimin e ndihmës reciproke, teknike, operative dhe mbështetëse.

Gjatë vitit 2021 u nënshkrua edhe Memorandumi i Bashkëpunimit ndërmjet AKI-së dhe IPK-së me qëllim të avancimit dhe thellimit të bashkëpunimit në mes të dy institucioneve, për të mbështetur njëra tjetrën në përmbushjen e mandatit të tyre kushtetues dhe ligjor.

b) Aktivitetet në fushën e marrëdhënieve me publikun

Varësisht sipas nevojave operative në teren, në bashkëpunim me departamente të ndryshme në kuadër të IPK-së janë publikuar komunikata për media, janë organizuar takime ku janë pasqyruar rezultatet e arritura nga IPK-ja. Aktivitetet e deritashme që janë realizuar gjatë vitit nga DPBÇLI në drejtim të fuqizimit të transparencës dhe bashkëpunimit me qytetarë kanë qenë:

- publikimi i rasteve që zgjojnë interesin e opinionit publik (kryesisht përmes komunikatave për media;
- dhënia e deklaratave për mediet;
- angazhime shtesë në fushën e marrëdhënieve me publikun;
- përgjigjja në kërkesat e adresuara nga mediet e ndryshme në çështjet që kanë të bëjnë me aktivitetet e IPK-së
- Kërkesat për qasje në dokumente publike etj.
- Përgatitja e Planit vjetor të IPK-së.

Në kuadër të këtyre angazhimeve janë trajtuar me qindra kërkesa përmes telefonatave të ndryshme nga mediat, mbi 200 kërkesa me shkrim të adresuara në adresën zyrtare të Divizionit për bashkëpunim dhe informim (DBI) si dhe janë publikuar më shumë se 60 komunikata për medie lidhur me aktivitetet e ndryshme të IPK-së.

Përveç këtyre angazhimeve ky Divizion ka përgatitur në baza të rregullta analizën – raportin e shtypit ditor lidhur me ngjarjet që janë mbuluar nga mediat dhe i cili është shpërndarë te zyrtarët e IPK-së.

DBI ka administruar dhe ka përditësuar edhe rrjetet sociale me fokus të veçantë në Facebook-un zyrtar. Secila komunikatë e cila është përcjellë për publikim në ueb faqen zyrtare është publikuar edhe në Facebook duke rritur në këtë mënyrë edhe numrin e ndjekësve në këtë rrjet social.

Duke ju referuar situatës së pandemisë dhe vështirësive që qytetarët kanë pasur për qarkullim të lirshëm, Divizioni për bashkëpunim dhe informim me përkrahjen e ICITAP-it gjatë vitit 2021 ka organizuar dhe marrë pjesë në disa aktivitete që kanë ndikuar në adresimin e ankesave të qytetarëve përmes formave të tjera si uebit zyrtar apo Linjës së kaltër.

Ndër temat që janë trajtuar në këto aktivitete kanë qenë:

- Rrugëtimi i IPK-së ndër vite – historik i shkurtër;
- Roli dhe misioni i IPK-së;
- Funksionimi i zyrave rajonale (si mundësi shtesë për qytetarë);
- Angazhimet e zyrtarëve të IPK-së gjatë kohës së Pandemisë dhe mundësia e raportimit të rasteve përmes platformave online;
- Bashkëpunimi me qytetarë;
- Bashkëpunimi ndërkombëtarë;



- Rastet më të shpeshta që hetohen nga IPK-ja;
- Integriteti policor;
- Linja e kaltër etj.

Një aktivitet i tillë është mbajtur me banorët e Restelicës (komuna e Dragashit) dhe në universitete publike e private etj.



Këto aktivitete kishte për synim diskutimet e hapura me qytetarë për fushëveprimin e IPK-së (rolin dhe autorizimet), shpjegimet për ecurinë e procedurës hetimore në rastet që trajton IPK në përputhje me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, procedura disiplinore dhe ecuria e saj dhe rëndësinë e integritetit policor.

Përfaqësuesit nga IPK-ja në këtë takim dhanë shpjegime për qytetarë lidhur me rolin e IPK-së, autorizimet ligjore si dhe projektit të regionalizimit të IPK-së respektivisht hapjen e zyrave rajonale të IPK-së në Prizren, Gjiilan dhe Mitrovicën e Veriut.

Publikimi i revistës “Integriteti” dhe buletinit mujor “Linja e Kaltër”




Ndër angazhimet e IPK-së në vitin 2021 për fuqizim të transparencës ka qenë edhe publikimi i revistës së rregullt “Integriteti”. Përveç informimit të brendshëm dhe atë kryesisht përmes shkrimeve të ndryshme të botuara në revistën zyrtare të IPK-së, kjo revistë konsiderohet si një projekt i rëndësishëm edhe për informimin e jashtëm e sidomos të zyrtarëve policor, partnerëve dhe qytetarëve për angazhimet e IPK-së.

Përveç revistës “Integriteti” në vitin 2021 IPK respektivisht Divizioni për bashkëpunim dhe informim ka filluar edhe me një projekt tjetër që i referohet fuqizimit të transparencës së brendshme duke publikuar çdo muaj buletin e titulluar “Linja e Kaltër”.

c) Bashkëpunimi ndërkombëtar

Bashkëpunimi me ICITAP-in



IPK-ja çmon lartë bashkëpunimin me ICITAP-in, i cili është i rëndësishë së veçantë. ICITAP ka ndihmuar IPK-në edhe këtë vit në zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale dhe teknike. Trajnimet që ka ofruar ICITAP-i ndër vite, kanë qenë mëse të nevojshme për IPK-në dhe të duhura për të arritur përbushjen e misionit të IPK-së. Gjatë këtij viti, IPK është përkrahur me trajnime specifike që kanë fuqizuar kapacitetet profesionale.

ICITAP-i përkrahu IPK-në për anëtarësim në NIAIA dhe në shkëmbimin e përvojave me agjenci të zbatimit të ligjit SHBA-ve. IPK këtë vit pranoi konfirmimin zyrtar për anëtarësimin e plotë në Shoqatën Kombëtare të Hetuesve të Punëve të Brendshme (NIAIA – National Internal Affairs Investigators Association) të SHBA-së duke qenë shteti i parë nga Evropa që u anëtarësua në këtë organizatë.

Anëtarësimi në këtë shoqatë pritet të ndihmojë Inspektoratin Policor në sigurimin e një platforme shtesë për shkëmbimin e informacionit dhe ekspertizës në lidhje me çështjet e mbikëqyrjes policore .



Pas anëtarësimit, IPK me përkrahjen e ICITAP-it mori pjesë edhe në konferencën profesionale të Shoqatës Kombëtare të Hetimeve të Brendshme (NIAIA) në Las Vegas - Nevada të SHBA-ve.

Delegacioni i IPK-së u mirëprit nga Bordi i Organizatës dhe Kryetari i bordit Jeremy Viduna dhe gjithashtu zhvilloi takime me delegacione të ndryshme pjesëmarrëse në këtë konferencë.

Në këtë konferencë ndër të tjera u diskutua për rëndësinë e përdorimit të inteligjencës, burimet e hapura dhe rrjetet sociale në hetime dhe menaxhimi i përgjigjeve, ballafaqimi me punonjësit policor të dyshuar si dhe trendet në hetimet e brendshme dhe mbikëqyrjen e organeve të zbatimit të ligjit.

Me përkrahjen e ICITAP-it, IPK realizoi edhe një vizitë tjetër studimore në SHBA në tetor të 2021-ës.

Delegacioni i IPK-së u mirëpritën nga NYPD (Departamenti i Policisë së New Yorkut), ku u njoftuan nga afër me punën e këtij Departamenti nga Komisionieri i Punëve të Brendshme Josef Reznik dhe nga zyrtarë të lartë të Policisë së New Yorkut. Delegacioni i IPK-së vizitoi Akademinë Policore të New Yorkut dhe Qendrën e Përbashkët Operative, si dhe gjatë vizitës studimore u pritën edhe nga Illyrian Society, organizata e policëve shqiptar në New York.

Me përkrahjen e ICITAP-it u realizua edhe një vizitë studimore gjatë muajit dhjetor në Uashington të SHBA-së.

Delegacioni i IPK-së gjatë vizitës ka zhvilluar takime në Departamentin e Policisë



Metropolitane të Uashingtonit ku janë njohur me praktikat për hetimin e përdorimit të forcës si dhe për pasqyrën e Byrosë së Punëve të Brendshme. Takime u zhvilluan edhe në Qendrën Komanduese të Incidentit të Departamentit të Policisë Metropolitane si dhe me Qendrën e Komunikimit të Brendshëm të Agjencisë si dhe në Akademinë e Policisë Metropolitane. Delegacioni i Kosovës vazhdoi vizitën edhe në Policinë e Shtetit të Virgjias në Richmond duke u takuar me Drejtorin e

Policisë së Shtetit.

Kjo vizitë studimore është organizuar me mbështetjen e ICITAP-it Amerikan dhe konsiderohet mjaft e rëndësishme në shkëmbimin e përvojave dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të IPK-së si një mekanizëm i rëndësishëm në fushën e sundimit të Ligjit.


Gjatë këtij viti IPK u përkrah nga INL/ICITAP edhe me donacion të pajisjeve mbrojtëse nga pandemia, trajnimit për menaxhimin e kontratave, trajnim pesëditor për mbledhjen e provave të udhëhequr nga FBI etj.

Bashkëpunimi me OSBE-në

Misioni i OSBE-së në Kosovë gjatë vitit 2021 ka ofruar përkrahje për IPK-në me trajnime të specializuara dhe me donacione të ndryshme. Misioni i OSBE-së ka përkrahur punonjësit e IPK-së me trajnim të avancuar për taktika mbrojtëse.

Përmes këtij trajnimi është arritur ngritja e kapaciteteve operative dhe taktike e zyrtarëve të IPK për përdorimin e taktikave mbrojtëse në përputhje me standardet e fundit ndërkombëtare.

IPK në kuadër të bashkëpunimit me Misionin e OSBE-së ka pranuar donacion 10 kompjuterë nga misioni i OSBE-së të cilët janë dhënë për nevoja të trajnimeve online dhe nevoja të tjera.



Bashkëpunimi me EPAC-un

Katër zyrtarë të IPK-së kanë marrë pjesë në konferencën e 20-të vjetore të EPAC-ut (European Partners Against Corruption – Partnerët Evropian Kundër Korrupsionit) dhe Asamblenë e Përgjithshme e cila u mbajt në Vilnius të Lituanisë.



Në këtë konferencë kanë marrë pjesë shumë delegacione të institucioneve të mbikëqyrjes policore dhe agjencive kundër korrupsionit nga shtete evropiane, si dhe përfaqësues nga EUROPOL-i dhe organizata tjera ndërkombëtare e rajonale.

Në kuadër punimeve në konferencë u trajtuan tema të rëndësishme që kanë të bëjnë me fuqizimin e luftës kundër korrupsionit si: korrupsioni dhe siguria nacionale, parandalimi i korrupsionit dhe fuqizimi i integritetit të zyrtarëve, bashkëpunimi rajonal në fushën e

antikorrupsionit etj.

Bashkëpunimi me SHÇBA

Në kuadër të bashkëpunimit m Shërbimin për Çështje të Brendshme dhe Ankesa (SHÇBA) të



Republikës së Shqipërisë në fund të vitit 2021 u realizua një takim pune. Ky takim u zhvillua në ambientet e Inspektoratit Policor të Kosovës dhe prezent ishin edhe prokurorë nga SPAK-u (Struktura e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar) dhe Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Takimi u zhvillua në kuadër të shkëmbimit të përvojës dhe

informacioneve të përbashkëta dhe në funksion të fuqizimit të bashkëpunimit gjatë hetimit të rasteve të përbashkëta.

Gjatë tërë vitit u vlerësua bashkëpunimi profesional ndërmjet të dy institucioneve homologe të mbikëqyrjes policore drejt fuqizimit të integritetit policor dhe goditjes së aktiviteteve të kundërligjshme që cenojnë besimin e publikut tek policia.

Që të dy agjencitë homologe (IPK dhe SHÇBA), vazhdojnë me angazhim të mëtutjeshëm drejt fuqizimit të bashkëpunimit në fushën e mbikëqyrjes policore dhe shërbimeve të kontrollit të brendshëm në të dy vendet, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit në luftën kundër dukurive negative në radhët e policisë si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të individit.

Bashkëpunimi me DCAF

DCAF këtë vit organizoi konferencë rajonale me temën « Këmbimi i përvojave për hetime të rasteve korruptive në institucionet e zbatimit të ligjit» ku pjesëmarrës ishin edhe zyrtarët e IPK-së.

DCAF përmes Programit Rajonal për Bashkëpunim Policor dhe Ndërtim të Integritetit në Ballkanin Perëndimor (PCIB) ka vazhduar me kontributin me aktivitete që synojnë rritjen e sigurisë në Ballkanin Perëndimor brenda kornizave të qeverisjes demokratike, sundimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Konferenca e cila u mbajt online (përmes platformës së Zoom-it) kishte në fokus hetimet e korrupsionit për të cilat akuzohen zyrtarët e policisë.

Gjatë konferencës, zyrtarët e IPK-së dhe pjesëmarrësit tjerë janë angazhuar në studime rastesh lidhur me hetimet për korrupsion të zyrtarëve të zbatimit të ligjit duke ndëgjuar por edhe ndarë përvojat mbi praktikat rajonale e evropiane gjatë hetimit (përvojat dhe praktikat nga Zvicra).

Gjatë konferencës u diskutua edhe për kulturën e organizatave policore, kodin e heshtjes në kuadër të kulturës së punës policore, sfidat e trajtimit të rasteve të korrupsionit etj.

9. SHËRBIMET FINANCIARE, ADMINISTRATIVE DHE SHËRBIMET E PËRGJITHSHME

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme ka rol mbështetës në menaxhimin e buxhetit, burimeve njerëzore, sistemeve të teknologjisë informative dhe shërbimeve logjistike në arritjen e objektivave të IPK-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë e DFSHP-së janë: menaxhon dhe mirëmban informatat për burimet njerëzore të IPK-së, asiston menaxhmentin në organizimin e brendshëm, ofron mbështetje administrative, logjistike dhe të shërbimeve të teknologjisë informative, siguron zbatimin e procedurave për përzgjedhjen dhe punësimin e personelit të kualifikuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, koordinon përgatitjen, zbatimin, raportimin dhe vlerësimin e buxhetit të IPK-së, koordinon zbatimin me kohë të detyrimeve financiare të IPK-së, menaxhon sistemin e arkivit dhe dokumentet e brendshme të IPK-së, ofron shërbime logjistike për IPK-në, mirëmban pajisjet e TI-së dhe ofron shërbime të TI-së.

DEPARTAMENTI PËR FINANCA DHE SHËRBIME TË PËRGJITHSHME

**Ofruar shërbime mbështetëse
për funksionet operative të
organizatës:**

- Menaxhuam buxhetin e ndarë dhe realizuam 99 % të tij;
- Vazhduam implementimin e projektit për digjitalizimin e Arkivës së organizatës;
- Pavarësisht situatës me pandeminë organizuam trajnime bazuar në Strategjinë e Trajnimeve të IPK-së,
- Menaxhimin e flotës së automjeteve të IPK-së

DFSHP ka të punësuar 18 punonjës dhe është i strukturuar në tre divizione:

- Divizioni për Buxhet dhe Financa;
- Divizioni i Burimeve Njerëzore; dhe
- Divizioni për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike.

DFSHP ka ofruar këto shërbime mbështetëse për funksionet operative të organizatës:

- Menaxhimin e buxhetit të ndarë i cili është realizuar 99.21%;
- Përfundimi i realizimit të fazës së dytë të projektit kapital “Funksionalizimi dhe Digjitalizimi i Arkivit të IPK-së, ku është bërë skanimi i të gjitha lëndëve arkivore”;
- Menaxhimin e flotës së automjeteve të IPK-së;
- Menaxhimin e pandemisë Covid-19 duke respektuar rekomandimet e IKSHPK-së dhe Vendimet e Qeverisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë;
- Realizimin e Planit të dalë nga Strategjia e Trajnimeve të IPK-së.

Tabela: Buxheti Final dhe Shpenzimet 2021:

	Buxheti FINAL	Shpenzimi	Mbetja/Bu.	Shp./Bu.(%)
Paga dhe Shtesa	1,032,840.48	1,031,993.00	847.48	99.92
Mallra dhe Shërbime	274,911.67	265,450.13	9,461.54	96.56
Shpenzimet Komunale	4,840.95	4,343.64	497.31	89.73
Projekte Kapitale	56,955.00	56,942.83	12.17	99.98
Totali	1,369,548.10	1,358,729.60	10,818.50	99.21

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme në Inspektoratin Policor të Kosovës ka përfunduar fazën e dytë të projektit kapital “Funksionalizimi dhe Digjitalizimi i Arkivit të IPK-së” të planifikuar për këtë vit. Në këtë fazë të këtij projekti, ka planifikuar të bëjë edhe digjitalizimin e Arkivit, ku ka arritur që gjatë kësaj periudhe të bëjë skanimin dhe klasifikimin e të gjitha lëndëve të cilat kanë qenë në depon e Arkivit që nga themelimi i IPK-së viti 2006 e deri në vitin 2020.

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme ka bërë menaxhimin e flotës së automjeteve të IPK-së, ku në vazhdimësi ka trajtuar kërkesat për servisimin e automjeteve, ka hartuar autorizimet, si dhe ka bërë sigurimin dhe regjistrimin e të gjitha automjeteve. Gjithashtu zyra e transportit ka bërë edhe inspektime të zakonshme dhe të jashtëzakonshme të flotës dhe po ashtu kanë krijuar kartelë fizike dhe elektronike mbi gjendjen e secilit automjet të IPK-së. Gjatë këtij viti, IPK ka arritur të shtoj flotën e automjeteve me rreth njëzet e nëntë për qind (29%) me 9 vetura të marra me qira dhe 3 vetura të pranuar donacion nga EULEX..

Gjatë këtij viti, IPK ka arritur marrëveshjen për qasje në databazat e ARC-së për zyrtarët e IPK-së.

Me ndihmën e Misionit të OSBE-së ka filluar projekti për krijimin e platformës së ueb faqes së IPK-së, ku kjo platformë ka shumë përparësi në krahasim me platformën dhe dizajnin e ueb faqes së vjetër. Gjatë krijimit dhe ri-dizajnit të ueb faqes së re, rendësi të veçantë i është kushtuar pranimit të ankesave online, ku ankesat e marra nga ueb faqja do të mund të shfrytëzohen nga Departamenti për Menaxhimin e Ankesave si statistika që gjenerohen nga CMS-i. Platforma e re ka edhe module tjera shtesë, si p.sh.: pyetjet e shpeshta, mundësinë e thirrjes automatike nga ueb faqja në numrin e telefonit të Linjës së kaltër, zyrtarin për sinjalizim në IPK, formularin për qasje në dokumente publike, si dhe shumë pjesë tjera të cilat janë shumë më efikase dhe efektive se sa platforma e vjetër.

Trajnimet profesionale për stafin e IPK-së kanë qenë të reduktuara për shkak të pandemisë, edhe pse kanë arritur të mbahen disa të tilla kryesisht me përkrahjen e vazhdueshme të ICITAP-it , misionit të OSBE-së në Kosovë, IKAP dhe AKSP-së.

Tabelat në vijim prezantojnë numrin e trajnimeve dhe pjesëmarrësve në trajnimet për stafin operativ dhe atij administrativ të IPK-së.

TRAJNIMET/ PUNONJES OPERATIV				
Nr.	Emri i Trajnimit	Organizatori	Muaji	zyrtar
1	Trajnimi Virtual "Shfrytëzimi i fëmijëve dhe shkeljet e të drejtave të njeriut	ICITAP	Mars	2
2	Seminar on Regional Security"	ICITAP	Prill-Maj	1
3	Trajnimi Virtual" Regional Workshop' 'Strengthening Integrity in Security Sector"	ICITAP	Qershor	1
4	Cybercrime for Organized Crime Inspectors	ICITAP	Prill	1
5	Trajnimi i Avancuar mbi Taktikat Mbrojtëse	OSCE	Qershor	14
6	Training on Webpage and Social Media Management	OSCE	Qershor	1
7	Southeast Europe Forum	ICITAP	Qershor-Korrik	1
8	Trajnimi i Avancuar mbi Politikat dhe Metodat e Inspektimit	OSCE	Qershor-Korrik	10
9	Training on Complaints and handling procedures	OSCE	Shtator	9
10	Krimet e urrejtës	AKSP-ATRC	Shtator	5
11	Trajnimin mbi vlerësimin e qelive dhe të drejtave të personave të arrestuar	OSCE	Shtator	16
12	Trajtimi dhe procedura e ankesave	OSCE	Gusht Shtator	10
13	National Internal Affairs Investigators Assoc 2021 Annual Training Confer held in Las Vegas--Nevada	ICITAP	Gusht	3
14	Hetimi i vendit të ngjarjes	ICITAP/FBI	Nëntor	24
15	Anticorruption Series Financial Investigation Course--Budapest-Hungari-- ICITAP--13-17.12.2021	ICITAP	Dhjetor	1
Totali i punonjësve që kanë ndjekur trajnimet			99	

TRAJNIMET/ PUNONJES ADMINISTRATIV				
Nr.	Emri i Trajnimit	Organizatori	Muaji	Zyrtar
1	Trajnimi për menaxhimin e kontratave	ICITAP/USAID	Prill	5
2	SZHMB	IKAP	Qershor	3
3	Programi i Investimeve Publike- PIP	IKAP	Qershor	1
Totali i punonjësve që kanë ndjekur trajnimet			9	

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme në Inspektoratin Policor të Kosovës, ka menaxhuar me sukses Pandeminë COVID-19, duke bërë shpërndarjen e maskave, dorezave dhe dezinfektuesve për stafin e IPK-së, si dhe duke u kujdesur që të respektohet mbajtja e distancës.



INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA
POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO



**NËSE MENDONI SE U JANË SHKELUR TË DREJTAT TUAJA
NGA ZYRTARËT POLICORË, RAPORTONI NË *LINJËN E KALTËR*:
AKO MISLITE DA SU VAŠA PRAVA PREKRŠENA OD STRANE POLICAJACA
POZOVITE NA *PLAVU LINIJU*:
IF YOU THINK YOUR RIGHTS WERE VIOLATED BY POLICE OFFICIALS,
REPORT IN *BLUE LINE*:**

**RAPORTONI PA PAGESË
IZVESTI BESPLATNO U
FREE OF CHARGE**



080003333

**Së bashku për një polici profesionale
Zajedno za profesionalnu policiju
Together for professional police**

IPK SIGURON KONFIDENCIALITET TË PLOTË NË TRAJTIMIN E INFORMACIONEVE
PIK OSIGURAVA POTPUNU TAJNOST U TRETIRANJU INFORMACIJAMA
PIK OFFERS FULL CONFIDENTIALITY IN TREATING THE INFORMATION